

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6047
E premte, 26 qershor 2020
çmimi 0.40 €

Hoti në Bruksel:
Liberalizimi i vizave mbetet
ndër çështjet më urgjente
në raport me BE-në | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYEMINISTRI EDI RAMA KA MBAJTUR FJALIM NË KUVENDIN E SHQIPËRISË LIDHUR ME AKTAKUZËN E ZYRËS SË PROKURORIT TË SPECIALIZUAR NDAJ PRESIDENTIT HASHIM THAÇI DHE ISH-KRYEPARLAMENTARIT KADRI VESELI | FAQE 4-5

Thaçi dhe Veseli janë në anën e drejtë të historisë

OPINION

PESË GABIMET E MËDHA NË KOSOVËN E PASLUFTËS | F. 7

Bedri ISLAMI



AKTUALE

SHKON NË 41 NUMRI I TË VDEKURVE NË KOSOVË NGA COVID-19 | F. 2

ZEMAJ THOTË SE MUND TË KETË NJË VALË TË DYTË TË KORONAVIRUSIT NË SHTATOR | F. 6

OSMANI TAKOI AMBASADORËT E VENDEVE TË QUINTIT | F. 6

EKONOMI

EKZEKUTOHEN PAGESAT PËR SKEMAT PENSIONALE DHE SKEMAT E TJERA SOCIALE | F. 9

PAS MIRATIMIT TË BUXHETIT NË KUVEND, BËHET EKZEKUTIMI I PAGESAVE PËR SHUMËN 170 EURO | F. 9

KULTURË

"BECOMING", NJË PËRVOJË E PASUR NË SHËRBIM TË IDEVE TË LARTA | F. 13

Lulëzim ETEMAJ



SPORT

GABOJNË PRISHTINA DHE BALLKANI, DRITA FORCON POZITËN E PARË | F. 20

Gjatë fjalës së tij në Kuvend, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli nuk kanë nevojë për mbështetje politike sa iu përket aktakuzave për krime lufta nga ana e Prokurorisë së Hagës, duke shtuar se përtej kësaj ata janë të vendosur në anën e drejtë të historisë. "E kanë bërë historinë vetë duke i dhënë asaj pandryshueshmërinë e mundshme në jetë të jetëve, si historia e çlirimit të asaj pjese të pandashme të kombit shqiptar që quhet Kosovë", ka thënë Rama dhe ka theksuar se kjo akuzë ka hedhur baltë jo vetëm mbi dy emra të përveçëm dhe Kosovën, por mbi të gjithë shqiptarinë



ËSHTË ANULUAR MBAJTJA E TAKIMIT TË 27 QERSHORIT NË UASHINGTON NËDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

PRITET RICAKTIMI I DATËS PËR TAKIMIN E UASHINGTONIT



I dërguari i posaçëm i ShBA-së për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, ka bërë me dije se së shpejti do ta ricaktojë datën për takimin e Uashingtonit. Ai ka

deklaruar se e kupton vendimin e kryeministrit Avdullah Hoti për mospjesëmarrjen në takimin që ishte paraparë më 27 qershor. Ndërsa njohësit e rrethanave politike e kanë ftuar spek-

trin politik që të reflektojë pas ngritjes së aktakuzave të para nga Specialja për Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin. Ata kanë thënë se tani Kosovës i duhet unitet kombëtar | FAQE 3

OVLUÇK-ja PARALAJMËRON PROTËSTA PËR TA KUNDËRSHTUAR GJYKATËN SPECIALE | FAQE 4



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Shkon në 41 numri i të vdekurve në Kosovë nga Covid-19

PRISHTINË, 25 QERSHOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të enjten për një viktimitë tjetër si pasojë e Covid-19, duke e çuar në 41 numrin e personave të vdekur me këtë virus në vendin tonë. Sipas njoftimit, pacienti 52-vjeçar me inicialet Sh. Sh. ishte nga Istogu. Ndërkohë, në raportin ditor të Klinikës Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës është thënë se aty

janë duke u trajtuar 106 pacientë të sëmurë me Covid-19.

Në mesin e tyre, 46 raste janë duke u trajtuar në reparte me oksigjenoterapi dhe përkujdesje intensive, shtatë prej të cilave janë në gjendje të rëndë. “Në repartin e Mjekimit Intensiv janë duke u trajtuar gjashtë raste, tri raste janë në gjendje shumë të rëndë duke u trajtuar me

oksigjenoterapi dhe përkujdesje intensive, si dhe tri raste janë në gjendje kritike me frymëmarrje të asistuar me respiratorë”, është thënë në njoftim.

Marrë parasysh të dhënat e fundit, autoritetet e Kosovës kanë regjistruar 2 363 të infektuar me koronavirus, prej raportimit të rasteve të para më 13 mars. Prej tyre, 1 171 persona janë shëruar.



Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, u takua me presidentin e Këshillit Evropian, Charles Michel

Hoti: Liberalizimi i vizave mbetet ndër çështjet më urgjente në raport me BE-në

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka nisur të enjten vizitën zyrtare në Bruksel. Ai është takuar me presidentin e Këshillit Evropian, Charles Michel. Kryeministri Hoti ka theksuar se liberalizimi i vizave mbetet ndër çështjet më urgjente në raport me Bashkimin Evropian. Ai ka vlerësuar se për Qeverinë e Kosovës përmbyllja e këtij kapitulli është shumë e rëndësishme, në mënyrë që qytetarët e Kosovës, sikurse edhe fqinjët e tyre, të mund të udhëtojnë lirshëm në vendet e BE-së

“Epoka e re”

BRUKSEL, 25 QERSHOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, gjatë vizitës zyrtare në Bruksel, të enjten ka takuar presidentin e Këshillit Evropian, Charles Michel. Gjatë takimit, kryeministri Hoti e ka njoftuar për prioritetet e Qeverisë së Kosovës, siç është procesi i liberalizimit të vizave, menaxhimi i pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, pakoja e rimëkëmbjes ekonomike, si dhe për përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për

forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit.

Kryeministri Hoti ka theksuar se liberalizimi i vizave mbetet ndër çështjet më urgjente në raport me Bashkimin Evropian. Më tej, kryeministri Hoti ka vlerësuar se për Qeverinë e Kosovës përmbyllja e këtij kapitulli është shumë e rëndësishme, në mënyrë që qytetarët e Kosovës, sikurse edhe fqinjët e tyre, të mund të udhëtojnë lirshëm në vendet e BE-së.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, gjatë vizitës zyrtare në Bruksel ka zhvilluar takim edhe me kryesuesin e Komitetit për Punë



të Jashtme në Parlamentin Evropian, David McAllister, me të cilin ka biseduar për procesin e liberalizimit të vizave dhe procesin e integritimit evropian të Kosovës. Po ashtu, kryeministri Hoti gjatë takimit

ka biseduar për procesin e dialogut dhe zhvillimet e fundit politike, me ç'rast ka shprehur orientimin përperëndimor të Republikës së Kosovës. Kryeministri Hoti me këtë rast ka thënë se Qeveria e Kosovës

është e angazhuar në avancimin e proceseve demokratike në vend, për thellimin e bashkëpunimit rajonal ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor në funksion të proceseve integruuese evropiane.

Veliu priti në takim Ileshkvin e Kosovës, biseduan për pandeminë Covid-19

PRISHTINË, 25 QERSHOR (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Agim Veliu, ka pritur të enjten në takim Ileshkvin e Kosovës, Imzot Dodë Gjergji, me të cilin ka biseduar për situatën e përgjithshme në Kosovë, me fokus menaxhimit e situatës me Covid-19. Me këtë rast, ministri Veliu ka falënderuar

ipeshkvin Dodë Gjergji për rolin e tij dhe të kishës katolike në Kosovë, për sensibilizimin e të gjithë qytetarëve, në veçanti atij të besimit katolik për respektimin e udhëzimeve të Qeverisë së Kosovës sa iu përket masave ndaj virusit Covid-19. Po ashtu, ministri Veliu e ka vlerësuar frymën civilizuese që po vazhdon të ndiqet nga krerët e besimeve fetare në

Kosovë për respektimin e të gjithë qytetarëve, pavarësisht besimit të cilit i takojnë.

Ndërsa Imzot Dodë Gjergji e ka uruar ministrin Veliu për detyrën, duke shprehur gatishmërinë e tij se do të vazhdojnë të ndikojnë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë si faktor i unitetit në mes të besimeve në vendin tonë.



Kryeministri Edi Rama ka mbajtur fjalim në Kuvendin e Shqipërisë lidhur me aktakuzën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe ish-kryeparlamentarit Kadri Veseli

Thaçi dhe Veseli janë në anën e drejtë të historisë

Gjatë fjalës së tij në Kuvend, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli nuk kanë nevojë për mbështetje politike sa iu përket aktakuzave për krime lufta nga ana e Prokurorisë së Hagës, duke shtuar se përtej kësaj, ata janë të vendosur në anën e drejtë të historisë. “E vetë e kanë bërë historinë, duke i dhënë asaj pandryshueshmërinë e mundshme në jetë të jetëve, si historia e çlirimit të asaj pjese të pandashme të kombit shqiptar që quhet Kosovë”, ka thënë Rama, duke theksuar se kjo akuzë ka hedhur baltë jo vetëm mbi dy emra të përveçëm dhe Kosovën, por mbi të gjithë shqiptarinë



EPOKA ERE Mal QORRAJ

TIRANË, 25 QERSHOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë të enjten, në Kuvendin e Shqipërisë, se është i prekur dhe i befashuar nga aktakuza e ngritur nga Prokuroria Speciale kundër presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe kreut të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli. “Besoj se e kam mirëkuptimin tuaj për të komunikuar përmes kësaj foltoreje me të gjithë shqiptarët lidhur me befashinë e djeshme kur pothuajse të gjithë jemi prekur me të dëgjuar se zyra e prokurorit të Kosovës njoftoi se i ka dorëzuar për shqyrtim Tribunalit Special aktakuzën për Thaçin dhe Veselin, që të dy nismëtarë ndaj revoltës ndaj Millosheviqit dhe UÇK-së. U dyshuakan për një varg krimesh që sfidojnë imagjinatën. Të jemi të qartë, drejtësia është drejtësi dhe nuk është drejtësia në vetvete dhe as kërkimi i saj nga një strukturë e miratuar me vullnetin e vet Kuvendit, që nge pikëpyetje të mëdha, të rënda, të papranueshme në heshtje, por është leximi i tekstit të shpërndarë në mbarë botën, për të lajmëruar një proces gjyqësor për dy figurat e luftës dhe të paqes në Kosovë. Një tekst i shkruar, i cili, edhe sikur të mos ketë asnjë zhvillim të mëtejshëm juridik, për ne që e kemi jetuar në rininë tonë atë kohë, i ngjan një fletërrufeje të revolucionit kulturor kinez, ku fryma diskredituese e fjalëve

asgjëson vetë prezumimin e pafajësisë”, ka thënë Rama. Ai ka shtuar se kjo akuzë ka hedhur baltë jo vetëm mbi dy emra të përveçëm dhe Kosovën, por mbi të gjithë shqiptarinë. “Pikërisht kjo e kthen atë tekst në një rrufe që godet shumë më përtej dy emrave të përveçëm, duke shpërndarë nëpër krejt botën sot, e zvogëluar prej shpejtësisë, prej vrapimit të lajmeve, një njoftim ku nuk është se hidhet një baltë marramendëse thjesht mbi Thaçin e Veselin, as mbi UÇK-në vetëm, por mbi vetë Kosovën dhe krejt shqiptarinë”, është shprehur Rama. Gjatë fjalës së tij në Kuvend, kryeministri Edi Rama u shpreh se Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli nuk kanë nevojë për mbështetje politike sa iu përket aktakuzave për krime lufta nga ana e Prokurorisë së Hagës, duke shtuar se përtej kësaj ata janë të vendosur në anën e drejtë të historisë. “E kanë bërë historinë vetë duke i dhënë asaj pandryshueshmërinë e mundshme në jetë të jetëve, si historia e çlirimit të asaj pjese të pandashme të kombit shqiptar që quhet Kosovë. Na duhet të bëjmë një hulumtim të shpejtë në kujtesë për ta sjellë tani në vëmendje se është falë tyre që u trondit ndërgjegjja tërësisht e fjetur e perëndimit demokratik në raport me Kosovën. Ata i hynë detit në këmbë duke pasur gjithë botën kundër, duke mos pasur asnjë vesh të hapur asgjëkund, në kërkimin e asaj që duket se aty ka qenë

gjithmonë, Kosova e pavarur, shtet sovran. Është falë tyre që u imponua edhe reagimi me bomba i aleancës më të madhe të planetit ndaj mizorive të luftërave të Jugosllavisë. Shfaqja e UÇK-së nuk është vetëm pikë kulmore e përpjekjeve të një populli, një populli të lënë me miratim ndërkombëtar për aq shumë dekada në një harresë poshtëruese”, ka thënë Rama. Akuzat e Prokurorisë Speciale, sipas kryeministrit Rama, po vënë në pikëpyetje padrejtësisht kauzën për liri dhe pavarësi të Ushtisë Çlirimtare të Kosovës. “Teksti i mbrëmshëm krijon perceptimin e tmerrshëm të një vendi mes të Evropës, ku falë krimeve të njerëzimit është instaluar një regjim kriminal. Në atë tekst duket sikur lexon për atdheun e agresorëve, jo për vendin e viktimave të agresionit. Ai tekst indinjues, që nuk është aktakuzë në vetvete, por është një prelude i pakuptueshëm në aspektin juridik, në aspektin e procedurës së një drejtësie të drejtë. Një prelude mediatic, i një procesi që më pas vijon, por që si i tillë nge një varg pikëpyetjesh, pikëpyetje të rënda jo vetëm për pastërtinë e udhëheqësve politikë, por edhe për kauzën e ushtisë së Kosovës”, ka thënë ai. Ndër të tjera, Rama thekson se

Serbia ishte agresorja që shkaktoi pasoja në jetën e shqiptarëve. “Serbia nuk ishte viktimë, por ishte agresorja dhe Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Ramush Haradinaj dhe të gjithë të tjerët u rebeluan ndaj agresorit në emër të viktimave, ky është fakt. Unë nuk flas për pastërtinë dhe për pafajësinë e UÇK-së. Ajo është vetëkuptueshme. Është e pastër, natyrisht dhe, nëse flas për të, kam frikë se me të vërtet shumëkush mund të thotë se po i shmanget asaj, për të cilën, në fakt, duhet folur”, ka thënë Rama, duke shtuar se në Kosovë gjithë populli është ushtar për botën demokratike dhe kjo nuk është dobësi. “Me atë tekstin e djeshëm nuk do të amnistohet kurrë, një njoftim në ajër që u bie kokës dy figurave. Kjo është një çorbë. Përballja e gjatë do ta bëjë UÇK-në më të fortë në kujtesën e shqiptarëve dhe do ta bëjë Kosovën me të mirë, edhe pse nuk duket kështu sot”, është shprehur Rama. Përgjatë fjalimit të tij në Kuvend mbi aktakuzat e Prokurorisë së Hagës ndaj Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit, kryeministri Edi Rama u ndal veçanërisht edhe te Ramush Haradinaj. “Ramush Haradinaj la detyrën e kryeministrit në vitin 2005, pikërisht për t’iu përgjigjur thirrjes për akuza për krime të

Tribunalit të Hagës dhe dy herë doli i pafajshëm. Për herë të parë në historinë e Tribunalit të Hagës ndodhi që një person i shpallur i pafajshëm të shpallet në rigjykim pas apelimit, përkundër faktit që vite e vite me radhë prokuroria nuk gjeti fakte. Një i pafajshëm që 10 vjet i jetoi me hijen e një persekutimi në kuptimin më të drejtë të fjalës, persekutim sepse dal i pafajshëm, më thërret prapë, nuk provon asgjë dhe prapë më paragjykon. Padyshim komandant në një nga zonat më të ashpra të luftës, ish-kryeministër i zvarritur një dekadë për të dëshmuar që është pa lidhje me krimet kundër njerëzimit, po thjesht ka udhëhequr një luftë, jo një marshim paqeje, ka humbur njerëz madje, ndërkohë që askush nuk merr asnjë përgjegjësi fare për gjithë këtë jetë të sakatuar”, ka thënë Rama, duke theksuar se i njëjti fat e ndoqi edhe Fatmir Limajn. Zyra e Prokurorit të Specializuar, me seli në Hagë, e njoftoi publikun të mërkurën se më 24 prill ka paraqitur në Dhomat e Specializuara një aktakuzë për shqyrtim, e cila e ngarkon presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryetarin e Kuvendit dhe kryetarin aktual të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, dhe persona “të tjerë” me krime kundër njerëzimit dhe krime lufte.

ËSHTË ANULUAR MBAJTJA E TAKIMIT TË 27 QERSHORIT NË UASHINGTON NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

PRITET RICAKTIMI I DATËS PËR

I dërguari i posaçëm i ShBA-së për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, ka bërë me dije se së shpejti do ta ricaktojë datën për takimin e Uashingtonit. Ai ka deklaruar se e kupton vendimin e kryeministrit Avdullah Hoti për mospjesëmarrjen në takimin që ishte paraparë më 27 qershor. Ndërsa njohësit e rrethanave politike e kanë ftuar spektrin politik që të reflektojë pas ngritjes së aktakuzave të para nga Specialja për Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin. Ata kanë thënë se tani Kosovës i duhet unitet kombëtar



EPOKA E RE Muahmet KOCI

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Është anuluar takimi i 27 qershorit në Uashington ndërmjet Kosovës dhe Serbisë pasi kryeministri Avdullah Hoti ka bërë me dije se nuk do të shkojë në këtë takim pasi Gjykata Speciale ka ngritur aktakuzat ndaj presidentit Hashim Thaçi dhe kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli.

I dërguari i posaçëm i ShBA-së për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, ka mirëkuptuar vendimin e kryeministrit të Kosovës. "Faleminderit kryeministër Hoti! Ne e kuptojmë vendimin tuaj dhe mezi presim ta ricaktojmë takimin së shpejti", ka shkruar Grenelli në "Twitter". Kryeministri Avdullah Hoti kishte treguar se pas

zhvillimeve të fundit duhet të kthehet në Pishinë për t'u marrë me situatën. "Për shkak të zhvillimeve të reja në Prishtinë, si rezultat i akuzave të dorëzuara nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, më duhet të kthehem në Prishtinë për t'u marrë me situatën. E kam njoftuar ambasadorin Grenell se nuk mund të marr pjesë në takimin e datës 27 qershor në Shtëpinë e Bardhë", ka shkruar Hoti në profilin e tij në "Facebook".

Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, ka thënë se duhet të sigurohet funksionimi i të gjitha institucioneve shtetërore para se të zhvillohet ndonjë takim me palën serbe.

Në profilin e tij në "Facebook", Mustafa ka shkruar se delegacioni i Kosovës në Uashington duhet të shkojë me

përkrahjen e koalicionit qeverisës dhe të opozitës. "Në LDK nuk ka konfuzion se a duhet të shkojë kryeministri në Uashington apo jo. LDK beson fuqishëm në ShBA-në. Për në Uashington u nis delegacioni shtetëror i Kosovës me vullnetin më të mirë, por u nda

përgjysmë sa ishte në aeroplan. Në Uashington shkohet me përkrahje të partive të koalicionit dhe të opozitës, sikurse edhe të të gjitha institucioneve shtetërore, jo vetëm me bindjen se kush duhet t'i prijë delegacionit", ka shkruar Mustafa.

Kosovës i dihet unitet më shumë se kurrë

Njohësit e rrethanave politike kanë bërë thirrje që, pas akuzave të para të Speciales, spektri politik duhet të bashkohet. Ata e kanë vlerësuar politike deklaraten e Zyrës së Prokurorit

OVLUÇK-ja paralajmëron protesta për ta kundërshtuar Gjykatën Speciale

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Drejtues të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) kanë paralajmëruar se do t'i shfrytëzojnë të gjitha mjetet demokratike për ta kundërshtuar Gjykatën Speciale dhe vendimet e saj dhe e kanë cilësuar atë si "raciste dhe të njëanshme".

Reagimi i tyre, të enjten në një konferencë për media në Prishtinë, erdhi pasi Zyra e Prokurorit Special në Hagë ka paraqitur të mërkurën aktakuzë për krime lufte kundër presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, kryetarit të Partisë Demokratike të

Kosovës, Kadri Veseli, dhe disa të tjerëve, emrat e të cilëve nuk janë bërë publikë.

Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hysni Gucati, ka thënë se Gjykata Speciale është gjykatë raciste dhe e njëanshme. "Kjo gjykatë është dashur t'i ndjekë edhe ata persona që jetojnë në Kosovë, sidomos serbët që kanë kryer krime lufte, që jetojnë të lirë në Mitrovicën e Veriut, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok apo edhe në vende të tjera", ka thënë Gucati.

Nënkryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Nasim Haradinaj, ka thënë se vendimet e Gjykatës Speciale janë të papranueshme dhe se



ligji për këtë gjykatë i miratuar në Kuvendin e Kosovës duhet të ndryshohet. "Ngritja e kësaj aktakuze është bërë me qëllim të caktuar, sidomos për ta penguar procesin e dialogut Kosovë

- Serbi. Organizata e Veteranëve të Luftës do t'i përdorë të gjitha format demokratike në kundërshtim të kësaj gjykate, duke mos përjashtuar edhe protestat, nëse e shohim si formë presioni

ndaj Kuvendit të Kosovës për të vepruar", ka thënë Haradinaj. Kuvendi i Kosovës e pati miratuar ligjin për formimin e Gjykatës Speciale në gusht të vitit 2015.

TAKIMIN E UASHINGTONIT



petkun institucional, atëherë ata e përfaqësojnë Kosovën. “Në momentin kur ata vishen me petkun institucional, ata nuk janë më individë, por janë president, kryeministër, ministër, kryeparlamentar etj., pra përfaqësues të shtetit dhe e përfaqësojnë interesin tonë. Sot kur jemi para rrezikut më të madh që nga viti 1999, liderët politikë më shumë se kurrë duhet t'i lënë anash rivalitetet politike të brendshme dhe t'i bëjnë ballë kësaj sfide të bashkuar. Çdo veprim tjetër shkon në favor të atyre forcave që janë duke e sfiduar qenësinë e shtetit të Kosovës”, ka thënë Ibrahimimi.

Edhe analisti tjetër politik, Albert Krasniqi, ka thënë se aktakuza ndaj Thaçit dhe Veselit ishte

politike. “Njoftimi për paraqitje të akuzës nga Prokuroria Speciale ndaj z. Thaçi dhe z. Veseli, pa u konfirmuar nga gjykatësi, me pretekstin për pengim të drejtësisë për ngjarje që kanë ndodhur para më shumë se dy vjetëve, për një akuzë të dorëzuar qysh në prill, por që njoftimi bëhet në prag të takimit në Uashington, lë shijen se është bërë për motive politike”, ka deklaruar Krasniqi, duke shtuar se një veprim i tillë ka dëmtuar kredibilitetin e kësaj gjykate. “Ky veprim e dëmton kredibilitetin e kësaj gjykate, themelimi i së cilës duket të jetë krejtësisht për arsye politike dhe jo për vendosje të drejtësisë. E kur puna e një gjykate udhëhiqet nga motivet e politikës, aty veç drejtësi nuk mund të presim”, ka shtuar ai.

BE-ja pret që dialogu Kosovë - Serbi të rifillojë në korrik

Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, ka deklaruar se është e nevojshme të vazhdohet dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Pas takimit me kryeministrin e Kosovës, Avdullah Hoti, i cili ka qëndruar të enjten në Bruksel për bisedime me zyrtarët evropianë, Michel ka deklaruar se BE-ja pret që dialogu Kosovë - Serbi të rifillojë në korrik.

“Gjatë takimit tonë theksova nevojën urgjente për përparim në dialogun Beograd - Prishtinë. Emërimi i fundit i ambasadorit, Miroslav Lajčak si Përfaqësues i Posaçëm i BE-së për dialogun Beograd - Prishtinë, ilustron fokusin e BE-së në këtë dialog, vazhdimi i të cilit është paraparë të ndodhë në muajin korrik në Bruksel”, ka deklaruar Michel.

të Specializuar për akuzat kundër presidentit Hashim Thaçi dhe për kryetarin e PDK-së, Kadri Veseli. “Deklarata e prokurorit të Gjykatës Speciale dje ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në takimin e Uashingtonit. Pra, një deklaratë e një institucioni gjyqësor ka

marrë rol politik. Kjo e dëmton rëndë kredibilitetin e kësaj gjykate. Lufta për rol udhëheqës në dialogun Kosovë - Serbi ndërmjet ShBA-së dhe BE-së duket se ka arritur deri në këtë gjykatë. Humbësja më e madhe padyshim se këtu është Kosova. Hashimi, Isa, Abini, Kadriu,

Ramushi, Vjosa, Fatmiri janë individë që kanë vendosur të jenë aktivë në politikë dhe garojnë kundër njëri-tjetrit ashtu edhe siç e do rendi në një rend demokratik”, ka thënë analisti politik Ilir Ibrahimimi. Ai ka deklaruar se në momentin që këta individë vishen me

Kuvendi i Kosovës anulon vazhdimin e seancës për dialogun

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Kuvendi i Kosovës e ka anuluar vazhdimin e seancës së nisur më 23 qershor për shkak të situatës së krijuar pas paraqitjes së aktakuzës nga ana e Prokurorisë Speciale në Hagë ndaj presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryetarit të Partisë Demokratike, Kadri Veseli. Të enjten ishte planifikuar vazhdimi i seancës, në të cilën do të diskutohej për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. Partia Demokratike e Kosovës kishte propozuar një rezolutë, mirëpo me kërkesë të grupit të saj parlamentar, kryesia e Kuvendit ka vendosur ta shtyjë vazhdimin e seancës. Zyra e Prokurorit të

Specializuar, me seli në Hagë, e njoftoi publikun të mërkurën, se më 24 prill ka paraqitur në Dhomat e Specializuara një aktakuzë për shqyrtim, e cila ngarkon presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryetarin e Kuvendit dhe deputetin aktual të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, dhe persona “të tjerë”, për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte, përfshirë vrasje, zhdukje me forcë, persekutim dhe torturë.

Presidenti Thaçi dhe kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, e kanë anuluar pjesëmarrjen në takimin e planifikuar të mbahet më 27 qershor në Shtëpinë e Bardhë mes delegacioneve të Kosovës dhe Serbisë.



Zemaj nënshkruan ndarjen e 300 eurove për specialistët vullnetarë gjatë koronavirusit

PRISHTINË, 25 QERSHOR (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka nënshkruar ndarjen e buxhetit për pagesën prej 300 eurove për muajin maj për kategorinë e specialistëve vullnetarë. Përmes një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook",

Zemaj ka thënë se ata janë përfitues nga pakoja fiskale emergjente, si personel i ekspozuar. "Në zbatim të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për masën 1.6. (Pakoja fiskale emergjente) sot kam nënshkruar ndarjen e buxhetit

për pagesën prej 300 eurove për muajin maj për kategorinë e specialistëve vullnetarë, përfitues nga pakoja fiskale emergjente e Qeverisë së Republikës së Kosovës për personelin e ekspozuar gjatë pandemisë Covid-19. Me kryerjen e kësaj pagese,

përmbillen obligimet financiare nga kjo pako sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për stimulimin dymujor të personalit që ka qenë i angazhuar dhe ekspozuar gjatë pandemisë Covid-19", ka shkruar Zemaj.



Zemaj thotë se mund të ketë një valë të dytë të koronavirusit në shtator

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije të enjten se në shtator mund të ketë një valë të dytë me Covid-19.

"Eventualisht mund të ketë edhe një valë të dytë në shtator ose tetor, por ne duhet të jemi të gjithë të përgatitur, të gjitha institucionet tona dhe ky është qëllimi i Ministrisë së Shëndetësisë", ka thënë Zemaj, duke paralajmëruar për teste masive për Covid-19



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka paralajmëruar mundësinë e fillimit të testeve masive për Covid-19. Ai ka thënë se institucionet janë duke vlerësuar situatën me pandeminë dhe se janë duke punuar në një strategji anti-Covid-19.

Zemaj këto komente i ka bërë të enjten në një vizitë në Komunën e Prishtinës, ku është takuar me kryetarin Shpend Ahmeti. "Jemi duke vlerësuar situatën që të kalojmë edhe në teste masive. Ne kemi formuar edhe grup ekspertësh brenda ministrisë i cili do të adresohet shumë shpejt me rekomandime të qarta edhe për testimet dhe për strategjinë e re anti-Covid 19", ka thënë Zemaj.

Ministri Zemaj nuk dha ma shumë detaje mbi numrin e

testeve që do të mund të sigurohen për ta realizuar testimin në masë dhe çka saktësisht do të nënkuptonte një testim i tillë.

Zemaj ka bërë me dije se mund të ketë një valë të dytë të virusit Covid-19 në vjeshtë. "Eventualisht mund të ketë edhe një valë të dytë në shtator ose tetor, por ne duhet të jemi të gjithë të përgatitur, të gjitha institucionet tona dhe ky është qëllimi i Ministrisë së Shëndetësisë", ka thënë Zemaj.

Ai ka treguar se kryetari Ahmeti e ka njoftuar që ekipet komunale të inspektorëve sanitarë vazhdimisht janë në terren, duke u shpjeguar qytetarëve dhe pronarëve të lokaleve, që e vetmja mënyrë për ta parandaluar përhapjen e këtij virusi është respektimi i rekomandimeve të IKShPK-së, përkatësisht mbajtja e higjienës, bartja e maskave dhe distanca fizike.

"Sensibilizimi në këtë drejtim prej gjithsecilit ndihmon më shumë. Duke ruajtur veten ne kujdesemi edhe për rrethintonë. Gjatë takimit biseduam edhe për vendimet e fundit të Qeverisë së Kosovës për lehtësimin e masave. Kjo do të ndikojë në zhvillimin normal të ekonomisë dhe bizneseve private, të cilat këta muaj kanë pësuar humbje. Zotohemi që edhe për këtë kategori qeveria Hoti do të jetë pranë, duke i mbështetur në procesin e

rimëkëmbjes ekonomike", është shprehur ai.

Zemaj ka theksuar se si ministër i Shëndetësisë është zotuar se do të bëjë çmos edhe për avancimin e sistemit shëndetësor në kryeqytet, por edhe për komunat e tjera, duke garantuar shërbime cilësore për qytetarët.

Ndërkaq kryetari Shpend Ahmeti ka treguar se në takim kanë diskutuar për situatën aktuale me Covid-19 në Prishtinë, tash pas rihapjes dhe

largimit të të gjitha kufizimeve në vend, për rekomandimet dhe strategjinë anti-Covid-19. Ai ka theksuar se Prishtina me kujdes po i zbaton dhe respekton të gjitha rekomandimet e dhëna nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike. "Edhe pse në kryeqytet janë rreth 400 raste aktive, gjendja është nën kontroll dhe, po ashtu, janë bërë gati edhe kapacitetet shtesë, në rast nevojë", ka thënë Ahmeti.

Osmani takon ambasadorët e vendeve të Quintit

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka zhvilluar të enjten një takim me ambasadorët e vendeve të Quintit. Vendet e Quintit përfshijnë: Shtetet e Bashkuara, Britaninë e Madhe, Francën, Gjermaninë dhe Italinë. Me anë të një postimi në rrjetin social në "Twitter", Osmani ka thënë se me ambasadorët e këtyre

shteteve ka diskutuar për zhvillimet e fundit politike. "Kisha një takim produktiv me ambasadorët Quintit për të diskutuar për zhvillimet më të fundit politike. I falënderova të gjithë për mbështetjen e vazhdueshme të vendit tonë dhe të gjitha institucioneve tona", ka deklaruar Osmani.

Takimi i saj me ambasadorët e këtyre vendeve vjen pas njoftimit të kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, për anulim të takimit, të plani-

fikuar më 27 qershor, në Shtëpinë e Bardhë. Në këtë takim, të ndërmjetësuar nga i dërguari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ishte planifikuar rinisja e dialogut mes këtyre dy vendeve.

Një ditë më parë edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka ndërprerë udhëtimin e tij në Uashington, pasi Zyra e Prokurorit të Specializuar, me seli në Hagë, e ka njoftuar publikun të mërkurën se më 24 prill ka



paraqitur në Dhomat e Specializuara një aktakuzë për shqyrtim, e cila e ngarkon presidentin e Kosovës,

Hashim Thaçi, ish-kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli, dhe të tjerë për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte.

PESË GABIMET E MËDHA NË KOSOVËN E PASLUFTËS



Bedri ISLAMI

Njoftimi i prokurorit të specializuar për ngritjen e akuzave ndaj presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe liderit të PDK, Kadri Veseli, dy nga drejtuesit kryesorë të luftës në Kosovë, në fakt ka qenë një akt i paralajmëruar, si në një kronikë e ditur. Nuk është ditur se ndaj kujt do të ngrihen akuzat e para dhe se cilët do të jenë të akuzuarit, por që Gjykata Speciale, e cila njihet si Dhomat e Specializuara të Kosovës, do ta fillojë aktivitetin e tyre, kjo dihej.

Rruga e tyre është hapur nga vetë deputetët e Kosovës, posaçërisht nga Thaçi dhe Veseli, dhe vetëm forca e tyre bindëse dhe autoriteti politik e shoqëror bëri të mundur krijimin e kësaj strukture, krejt të veçantë, e pandodhur më parë, diçka që, aq sa ishte jashtë mendjes, aq ishte edhe e habitshme, pasi, ndoshta, për herë të parë dhe të fundit në historinë e pasluftërave, të akuzuarit do të ishin ata që i kishin dalë për zot vendit dhe njerëzve të tyre, ndërsa bartësit e krimeve, masakrave, vrasjeve, përdhunimeve, djegieve, dëbimeve, do ta kundronin të gjithë këtë nga një lozhë e epërme, si të ishte duke u zhvilluar akti i fundit i tragjedisë së një populli.

Si erdhi puna deri këtu, pra deri në çastin kur viktimat synohet të ketë rivasjen e saj dhe vrasësi ta shijojë këtë?

E gjithë ajo që thuhet nga strukturat jashtë Kosovës, se “nuk e kemi me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, por me individë të veçantë, që jashtë strategjisë së ndjekur, privatisht ose në grup kanë bërë krime”, është një përrallë që mund të nanurisë t'i vegjlit, t'i shpërblejë strukturat kundër luftës, njëkohësisht kundër lirisë, ta dëmshpërblejë agresorin dhe ta vendosë nënshtrimin e atyre që fituan një luftë të përgjakshme, e fundit luftë në kontinentin e vjetër, që i ngjante asaj që kishte ndodhur afërsisht në mesin e tij, me falangat naziste.

Asgjë nuk e ka dalluar nazizmin nga fashizmi nacionalist serb.

Në përfundimin e luftës gjërat ishin të qarta, të dukshme dhe të prekshme. Rreth 15 mijë të vrarë nuk ishin varrosur ende si duhet, ata ishin mbuluar me dherat e Kosovës, por varre nuk kishin; më shumë se 2 400 ushtarë të UÇK-së ishin vrarë, rreth 2 800 civilë ishin zhdukur; në mesin e të vrarëve më shumë kishte fëmijë, gra dhe pleq sesa burra të aftë për luftë.

Kushdo i shihte krimet, të pranishme, të kudondodhura. Në më shumë se 2 000 vendbanime nuk kishte mbetur më asgjë.

Krimi dihej, emri i kriminelëve njihet, pritej ndëshkimi. Por, të trullësuar nga ideja e fitores, nga ngazëllimi se tani po niste një jetë ndryshe, ku do të ishin zot dhe ku krimi njihet dhe dihej se kush ishte bartësi, të gënjer se përkrahja ndërkombëtare, pasi e kishin prekur krimin, do të ishte edhe më tej, shqiptarët në Kosovë harruan dhe bënë pesë gabime të mëdha, ndonjërin edhe mund ta ndreqin, me gjithë vonesën, por kjo do t'u kushtojë.

Gabimi i parë: Shqiptarët e morën lehtë pasluftën. Deri asaj dite ata kishin njohur vetëm krimin serb, por nuk e mendonin se paslufta ka ligje dhe rregulla të tjera.

Naivisht menduan se lufta mbaroi, ne jemi këtu, serbët pushtues ikën, krimi dihet, kriminelët po ashtu, rrënoja e tragjedisë është e pranishme dhe kaq.

Ata harruan se mashtrimi është veti kombëtare serbe.

Të gjitha qeveritë dhe të gjithë parlamentet e Kosovës, që nga i pari dhe deri tani, herë-herë i përbëri në shumicë nga ata që quheshin rryma e bisedimeve, shumë nga të cilët kishin qenë pjesë e mekanizmit pushtues serb, e deri tek i fundit, ku janë në shumicë dërrmuese njerëz të ardhur nga lufta apo familje të njohura të luftës, nuk nxorën aktin themeltar të dëshmisë së krimeve: ta merrnin vendimin parlamentar dhe ta akuzonin Serbinë për atë që, në fakt, kishte ndodhur: Gjenocidin shtetëror serb mbi një trevë shqiptare.

Ata nuk e bënë kurrë këtë. Me gjithë këmbënguljen e shumë figurave të njohura politike të Kosovës, Kuvendi dhe Qeveria, njëherësh, kurrë nuk e menduan se duhej shpallur gjenocidi serb jo përmes deklaratave politike apo artikujve medialë, por zyrtarisht, mbi bazën e një vendimi të posaçëm, të formulohet akuzat, të mblihdeshin dëshmi dhe të paraqiteshin para botës, duke kërkuar dënimin e një shteti vrasës.

Të tkurrur nga trysnia ndërkombëtare, e cila po kërkonte rrugë paqe, duke rënduar viktimën, secili politikan i nivelit të lartë heshti dhe tani ndiejnë pasgoditjen e pamenduar.

Gabimi i dytë: Kosova e pasluftës, më shumë se gjithçka tjetër, kishte nevojë për bashkëpunimin mes vetes. Shumë gjëra kishin ndodhur, tronditje të mëdha kishin kaluar, mëri të mëdha, deri në urrejtje ishin ngjeshur me njëra-tjetrën, por nuk mund të ndërtohej shteti i ri duke pasur tronditje, mëri, hasmëri dhe urrejtje.

Nëse kjo frymë bashkëpunimi mes shqiptarëve dukej e natyrshme, ajo u duhej afruar edhe pakicave. Sidomos pakicave serbe që nuk e kishin implikuar veten në luftë, sado të paktë të ishin ato.

Në ditët e fundit të qershorit 1999, sapo lufta kishte mbaruar, Thaçi si kryeministër i Qeverisë së Përkohshme, në fakt një qeveri të cilën e njohën të huajt, por jo një pjesë e shqiptarëve, bëri një thirrje të pazakontë, duke u kërkuar serbëve të mos largohen nga Kosova dhe se, së bashku, mund të bashkëjetojnë si të barabartë.

E mbaj mend mirë furtunën e ngritur kundër tij, megjithëse në ato ditë ishte lideri i pakontestueshëm. Më shumë u ngrifosën me nacionalizëm ata që sot duartrokasit akuzën ndaj tij.

Përdallimet u bënë të rënda. Një grup i ngritur nga LDK-ja, me drejtues Ekrem Kryeziun e Prizrenit, kishte marrë detyrën e evidentimit të krimeve të luftës nga UÇK-ja, duke e përjashtuar krimin serb dhe materialet, të krijuara nga mëria dhe jo nga e vërteta, tashmë janë pjesë e dosjeve të krijuara.

Asnjëherë nuk kishte ndodhur kjo. Nuk besoj se do të mund të ndodhë në një vend tjetër.

Paslufta risolli ndarjen, nga e cila përfitoi ajo që e kishte krijuar, struktura e fshehtë serbe dhe lobi serb në Kosovë, të cilët, kur shqiptarët ranë në gjumin e paqes, nisën vazhdimin e luftës.

Gabimi i tretë: krimi në Kosovë më shumë u dokumentua privatisht sesa nga qeveritë e Kosovës. Qeveritarët u dhanë pas plaçkës, tenderëve, harruan përse kishin luftuar ose përse u bënë qeveritarë, por krimin e harruan. Të pasur, mospërfillës, shumë nga të cilët të paditur, duke e ruajtur veten zotërinjtë e Kosovës, u bënë mospërfillës ndaj vlerave, së shkuarës, miqve dhe shokëve, ndodhi kthimi i tyre, mjerisht, në mercenarë.

Qeveritë e Kosovës që ndërroheshin, duke e quajtur gjithnjë opozitën tradhtarë dhe opozita duke e trajtuar qeverinë si kolaboracioniste, harruan se kishin përballë një shtet mafioz, i mësuar me krimin dhe fshehjen e tij.

Ndërsa në Kosovë flinin dhe merreshin me pasuritë, shteti serb ngriti struktura të posaçme, me akademikë, shkencëtarë, geologë, historianë, specialistë të çështjeve të sigurisë, politikanë, u dha atyre një status të veçantë, si një qeveri në hije dhe, përmes tyre, ndërtoan strategjinë e mposhtjes në Kosovë në paqe, të cilën e kishin humbur në luftë.

Kur kishte dëshmitarë, të cilët e kishin parë ngjarjen me njërin sy, kjo strukturë u shtonte edhe dhjetëra sy të tjerë, i incizonte serbët e larguar nga Kosova,

shumë nga të cilët kishin qenë paraushtarakë, që veshën uniformën dhe vranë fqinjët shqiptarë, mori pranë vetes “shqiptarë të ndershëm”, që u kishin shërbyer atyre, krijoi deklaratat e tyre dhe, jorastësisht, nuk tërhoqi asnjë, ose thajse asnjë, nga të njohurit si specialistë të njohur, të hapur dhe funksionarë të lartë të shërbimit të tyre të fshehtë. Ata që mbetën në Kosovë u bënë pjesë e hetimeve. Ata që i morën në shtetin serb do të mund të jenë një ditë dëshmitarë e fshehur.

Të tillë do të jenë edhe shumë shqiptarë “të devotshëm”, pa përjashtuar edhe rastet kur, qoftë për mendësi vetjake apo nga urrejtja, mund të jenë bërë krime. Kosova humbi në pasluftë atë që kishte fituar në luftë.

Ndërsa shteti serb mbushi gjithë botën me 2shifra alarmante, bleu media të rëndësishme, e paraqiti një vrasje, që nuk dihej nga kishte ardhur, në dhjetëra variante, Kosova heshti.

Edhe libri “Mashtrimi i madh”, i politologut të njohur Bardhyl Mahmuti, i përkthyer në disa gjuhë, shumë herë me kontribute miqësore, mbeti në magazinat ministrale.

Gabimi i katërt: Kuvendi i Kosovës, nën trysninë ndërkombëtare, miratoi ngritjen e Gjykatës Speciale, duke u ngritur nga një raport i Dik Martyt, i cili, po ashtu, kishte shfrytëzuar dy burime, materialet e Karla del Pontes, ish-kryeprokurores zvicerane për krimet e luftës dhe, mbi të gjitha, një raport disa qindra faqesh që shteti serb kishte përgatitur, duke blerë haptas, pa drojë, edhe ish-funksionarë të lartë ndërkombëtarë që kishin punuar në strukturat e drejtësisë në Kosovë e, po ashtu, edhe rioshë shqiptarë që u përfshinë në këto struktura, shumë nga të cilët përkthyes, por që bashkëpunuan mjaftueshëm.

A ishte i domosdoshëm ky akt, krijimi i një gjykate, e cila do t'i hetonte vetëm pjesëtarët e ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila, edhe tani, pas kaq shumë viteve hetim e gjurmim, mund të akuzohet për rreth 100 vrasje, shumë nga të cilat, ose të gjitha pa autorë, ndërsa vrasjet e 15 mijë shqiptarë të mbetnin anonimë.

Parlamenti u ndodhi atëherë në dilemën ndërkombëtare: Nëse nuk e miratoni ju, këtë do ta bëjë Këshilli i Sigurimit, ku kishte shtete që nuk e njihnin Kosovën, si Rusia e Kina, që donin ta ndëshkonin, por që ta ndëshkonin duhet ta njihnin si shtet, ose shtetet që e kishin njohur të parët, si ShBA-ja, Anglia etj., duhet ta çnjihnin. Është çudia e pasluftës.

Në ato ditë kam pasur takime të shpeshta me liderë politikë të Kosovës dhe, me gjithë atë që kam qenë i detyruar të përcillja,

ua kam thënë edhe mendimin vetjak të disa institucioneve serioze, që të mos ketë ngutje dhe të mos ketë ndarje të krimit si veti nacionale.

Në muajin shkurt të vitit 1999, kur serbët kishin bërë masakrat e mëdha dhe po përgatiteshin për masakrat e stërmëdha, në një akuzë zyrtare të tyre, përmes një institucioni ndërkombëtar, ankoreshin për vetëm 5 serbë të zhdukur, disa nga të cilët jetojnë ende sot e kësaj dite.

Atëherë mendonin se luftën e kishin fituar dhe se shqiptarët do të dëboheshin. Kishin arritur të gjenin pesë emra dhe kaq. Me kalimin e viteve ata e rritën dozën, shtuan gjithçka mundnin sipas vetisë së tyre tradicionale, mashtrimi; të gjallët u shpallën të vdekur, kriminelët të vrarë në luftë u quajtën të vrarë në pragun e shtëpive.

Cilin do ta gjykojnë Dhomat e Specializuara të Kosovës?

Enigmë që e zgjidhi prokurori i specializuar përmes një njoftimi politik!

Gabimi i pestë: Në Kosovë ka pasur një detashment njerëzish në strukturat e larta të shërbimit të fshehtë. Shqiptarë të njohur, figura që kishin bërë një mijë e një të zeza mbi të burgosurit, të cilët, në pasluftë e jetën veten si një veshkë mes dhjamt.

Ndodhi kështu sepse, ndryshe nga ajo që ndodhi në Shqipëri, ku sigurimi i shtetit, të paktën publikisht u dënua, aty nuk ndodhi asgjë. Oficerë të shërbimit ishin dhe ashtu mbetën. Nëpunës të lartë, deri ministra të qeverisë së fundit të Millosheviqit në Kosovë ishin dhe ashtu mbetën. Disa u bënë deputetë, ndonjëri ministër e deri në shef qeverie.

Ish-shefat e shërbimeve të fshehta u atashuan pranë strukturave ndërkombëtare dhe filluan ndëshkimin e luftës. Fadil Sylejviqi dhe Mehmet Loci janë disa nga emrat e njohur.

Fadil Sylejviqi që kishte rrëmbyer mjekun e njohur, atdhetarin e shquar, doktor Shala, pikërisht kur filloi lufta dhe e kishte zhdukur trupin e tij, u thirr të hetonte dhe krijoi aq shumë dosje të rreme dhe hapi aq shumë trillime, sa që u kërkua edhe në parlament ndëshkimi dhe dëbimi i tij.

Çuditërisht, edhe nga pushtetarët u mbajtën afër. Mehmet Loci ishte këshilltari dhe ngritës i strukturave të sigurisë pranë LDK-së, Fadil Sylejviqi gjendej pranë një ish-anëtari të Shtabit të Përgjithshëm. Funksionarë të lartë të shërbimit dhe të politikës morën frymë lirisht, pasi u shërbyen politikanë për t'i ngritur dosjet për njëri-tjetrin. Mospastrimi i politikës ka sjellë forcimin e lobit serb në Kosovë. Ata shpeshherë vendosin. Si duket, qofsha i gabuar, do të vendosin edhe për shumë kohë!

Krasniqi e ambasadori turk flasin për mundësinë e rritjes së shkëmbimeve tregtare

PRISHTINË, 25 QERSHOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar, me të cilin kanë diskutuar për bashkëpunimin ekonomik në mes të dy vendeve.

Ministri Krasniqi ka falënderuar shtetin e Turqisë për ndihmën e vazhdueshme ndaj Republikës së Kosovës dhe e ka njoftuar për masat që janë duke u marrë për t'i mbështetur bizneset dhe prodhuesit. Krasniqi e ka njoftuar ambasadorin për prioritetet e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, duke

theksuar se Turqia është një prej investitoreve kryesore në Kosovë.

Në takim është diskutuar edhe për marrëveshjen tregtare Kosovë - Turqi dhe shkëmbimet tregtare. Ministri Krasniqi ka thënë se do të krijohet një ekip që do t'i krijojë lidhjet në mes të bizneseve turke dhe kosovare dhe përmes pjesëmarrjes nëpër panairë të rriten shkëmbimet tregtare. Ndërsa ambasadori i Turqisë ka thënë se do t'i avancojnë marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Turqisë dhe ka shprehur gatishmërinë për ta shfrytëzuar potencialin e vendit të tij për ta mbështetur Kosovën.



Guvernatori Mehmeti dhe ministri Kuçi diskutojnë për zhvillimet në ekonomi



PRISHTINË, 25 QERSHOR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka pritur të enjten në takim ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi. Guvernatori Mehmeti e ka

njoftuar ministrin Kuçi mbi zhvillimet e fundit në sistemin financiar si dhe për rolin që ky sistem ka pasur për minimizimin e pasojave ekonomike të pandemisë gjatë periudhës së masave kufizuese. Gjithashtu,

guvernatori Mehmeti e ka njoftuar ministrin lidhur me kontributin e BQK-së për hartimin e planit të rimëkëmbjes ekonomike. Me këtë rast, guvernatori Mehmeti ka deklaruar se BQK-ja mbetet e përkushtuar që ta japë kontributin

e vet për lehtësimin e mëtejshëm të qasjes në financa përmes rolit të saj si rregullatore dhe mbikëqyrëse e sistemit financiar.

Nga ana tjetër, ministri Kuçi e ka njoftuar guvernatorin Mehmeti me planet e Ministrisë së

Ekonomisë dhe Ambientit dhe ka shprehur përkushtimin që të angazhohet për të krijuar sa më shumë mundësi për një ambient që promovon zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë së vendit.

Ministri Mustafa: Do ta vazhdojmë përkrahjen e prodhuesve vendorë

PRISHTINË, 25 QERSHOR (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, të enjten ka pritur në takim kryetarin e Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, me të cilin kanë diskutuar për gjendjen

aktuale dhe për mundësitë e bashkëpunimit.

Kryetari Shahini e ka njoftuar ministrin Mustafa me sfidat e bizneseve vendore gjatë dhe pas pandemisë Covid-19. Në anën tjetër, ministri Mustafa ka

falënderuar kryetarin e AKB-së për vizitën dhe ka theksuar se do ta vazhdojë bashkëpunimin me qëllim të përkrahjes së prodhuesve vendorë, duke siguruar avancimin dhe zhvillimin ekonomik të vendit.



Ekzekutohen pagesat për skemat pensionale dhe skemat e tjera sociale



Pas miratimit të buxhetit në Kuvend bëhet ekzekutimi i pagesave për shumën 170 euro

Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka bërë me dije se komisioni është duke punuar me një intensitet dhe përkushtim të lartë në verifikimin e kërkesave të tatimpaguesve, të cilët kanë aplikuar për të përfituar nga pakoja e kaluar. Sipas saj, gjatë verifikimeve nga komisioni po konstatohen parregullsi gjatë aplikimit, gjë që po vështirëson punën e komisionit.

Bajrami ka thënë se është lajm i mirë që komisioni tanimë është në finalizim të verifikimit të të gjitha aplikimeve dhe, sipas saj, të enjten do të përfundojnë verifikimet e të gjitha kërkesave për kompensim të qirasë dhe deri në fund të kësaj jave do të përfundojnë verifikimet, gjegjësisht validimet finale në të gjitha masat si: Masa 3a (kompensimi në pagë prej 170 eurosh), 3b (qiraja 50 për qind), 7 (pagesë shtesë në vlerë prej 100 eurosh për punëtorët e dyqaneve

ushqimore, furrave dhe barnatoreve), 8 (pagesë e asistencës mujore në vlerë prej 130 eurosh për qytetarët që kanë humbur punën për shkak të pandemisë) dhe 14 (mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorët me kontratë pune së paku njëvjeçare gjatë periudhës së emergjencës së shëndetit publik nga 130 euro). “Ndërkohë, ju njoftojmë që edhe listat e përfituesve për masën 15 (pagesa e asistencës mujore në vlerë prej 130 eurosh për qytetarët me kushte të rënda sociale të lajmëruar si të papunë) janë në finalizim dhe shumë shpejt do të bëhet ekzekutimi nga Thesari. Ministria e Financave siguron qytetarët e Kosovës që do ta vazhdojë implementimin e masave të pakos dhe se ekzekutimi i pagesave do të shtohet pas miratimit në Kuvend të buxhetit të rishikuar për vitin 2020”, ka thënë ministrja Bajrami.

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Ministria e Financave ka njoftuar se Thesari i Kosovës ka ekzekutuar pagesat për skemat pensionale dhe sociale për 289 613 përfitues për muajin qershor 2020, sipas afatit të zakonshëm për pagesën e këtyre skemave mujore, si në vijim: Pensionet bazë, pensionet kontributive, pensionet për personat me aftësi të kufizuara, pensionet e FSK-së, pensionet e TMK-së, pensionet e parakohshme - Trepça, kompensimi për personat e verbër, pensionet familjare, pensionet e invalidëve të punës, për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara

të përhershme, strehimit familjar brenda farestit, strehimit familjar jashtë farestit, pensionet e veteranëve, pensionet për viktimat, pensionet e invalidëve të luftës, pushimin e lehonisë, për kompensuesit e arsimit për vitet '90.

Sipas njoftimit të kësaj ministrie, pagesa e muajit qershor përfshin edhe zbatimin e masës dy (2) për përfitimin e shtesës prej 30 eurosh për kategoritë e caktuara si dhe pagesën për të rikthyerit përkohësisht në listat e përfituesve, të paraparë me pakon emergjente fiskale, me ç'rast është përmblyllur edhe ekzekutimi i kësaj mase të pakos emergjente.

Po ashtu, Ministria e Financave njofton se është realizuar

ekzekutimi i pagesave për masën 3b-subvencionimi i qirasë deri 50 për qind, për 3 599 përfitues në vlerë totale prej 634 064.78 euro, ndërsa janë në proces të finalizimit edhe 4 193 përfitues në vlerë totale 1 354 685.70 euro. “Shfrytëzojmë rastin t'i lusim përfituesit që të kenë kujdes të shtuar, t'i shmangin radhët apo grumbullimin para sporteve, në pajtim me udhëzimet nga institucionet shëndetësore për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Ritheksojmë se sistemi bankar është mjaft likuid dhe stabil; degët bankare janë të furnizuara mirë me para të gatshme si dhe mjetet në llogaritë tuaja bankare janë tërësisht të sigurta”, bëhet me dije në njoftimin për media.

Reçica raporton për zbatueshmërinë e masave të parapara në Pakon Fiskale Emergjente

PRISHTINË, 25 QERSHOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenie Sociale, Skender Reçica, ka raportuar të enjten para Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, lidhur me zbatueshmërinë e masave të parapara në Pakon Fiskale Emergjente të miratuar nga qeveria për t'u dalë në ndihmë shtresave të varfra të shoqërisë dhe bizneseve të prekura nga pandemia Covid-19.

Reçica anëtarët e komisionit i ka njoftuar për të gjitha hapat që kanë ndërmarrë si MPMS, në funksion të zbatimit të masave për të cilat janë përgjegjës, konkretisht për masën e parë, pagesën e dyfishtë të vlerës së skemës sociale (për tre muaj). Masën e dytë, pagesën shtesë

prej 30 eurosh në muaj për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin më pak se 100 euro (për tre muaj), si dhe masën e pesëmbëdhjetë - pagesën mujore prej 130 eurosh për qytetarët e lajmëruar si të papunë dhe që nuk kanë të hyra të tjera mujore nga buxheti i shtetit, masë kjo që ka gjetur pak vështirësi në zbatim, jo për fajin e MPMS, por kryesisht për arsye teknike. “Në këtë mbledhje të komisionit anëtarët i njoftova edhe për prioritetet e ministrisë dhe kërkova mbështetjen e tyre për realizimin e planit legjislativ nga fusha e punës dhe mirëqenies sociale, me theks të veçantë jetësimin e reformës pensionale”, ka thënë ministri Reçica.



Arton Gavazi emërohet nënkryetar i Komunës së Ferizajt

FERIZAJ, 25 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka emëruar Arton Gavazin, nënkryetar të kësaj komune, pas dorëheqjes së Naim Feratit nga kjo

pozitë. "Nënkryetari i ri i komunës është master i shkencave juridike, kuadër profesional i dëshmuar, i cili që nga sot do t'i kryejë detyrat e ushtrijë kompetencat e

nënkryetarit të Komunës së Ferizajt. Nënkryetari Gavazi mbante pozitën e drejtorit të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme. Ekipi qeverisës i kryetarit Aliu edhe me këtë

rast po dëshmohej me kuadro e dije profesionale, moshë të re e përgatitje superiore për t'u shërbyer qytetarëve ferizajas", ka njoftuar Komuna e Ferizajt.



Komuna e Kamenicës pranon donacion një gjenerator nga UNMIK-u

KAMENICË, 25 QERSHOR (ER) - Komuna e Kamenicës ka pranuar donacion një gjenerator që do të ndihmojë për kryerjen e punëve të administratës komunale.

Ky donacion është dhuruar nga UNMIK-u.

Kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka falënderuar UNMIK-un për donacionin, i cili do të shërbejë për nevojat e administratës komunale. "Nga UNMIK-u kemi pranuar donacion gjeneratorin që do të shërbejë për nevojat e administratës komunale. Falënderoj nga zemra përfaqësuesin special të sekretarit të përgjithshëm të OKB-së/UNMIK, Zahir Tanin, për këtë donacion", ka thënë Kastrati.

Ndërsa donacionin e ka pranuar drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Naim Arifi, i

cili, duke falënderuar donatorin, ka thënë se donacionet e tilla e ndihmojnë mjaft shumë komunën. "Falënderoj donatorin për

këtë gjenerator! Donacionet e tilla janë gjithmonë të mirëpritura sepse plotësojnë disa prej nevojave tona komunale", ka thënë ai.



Ambasada japoneze i dhuroi një automjet Brigadës së Zjarrfikësve në Podujevë

PODUJEVË, 25 QERSHOR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka pranuar të enjten donacion një automjet nga Japonia për Brigadën e Zjarrfikësve në Podujevë. Me këtë rast, nënkryetari Rudari ka falën-

deruar Ambasadën e Japonisë për donacionin, i cili do ta ndihmojë shërbimin e zjarrfikësve të kësaj komune. "Shpresoj se ky automjet të shfrytëzohet sa më pak dhe të kemi raste sa më të rralla të shpërthimit të zjarreve", ka thënë Rudari.

Nënshkruhet marrëveshja për ndërtimin e 12 shtëpive në Drenas dhe Skenderaj

DRENAS/SKENDERAJ, 25 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka nënshkruar një marrëveshje bashkëfinancimi me Shoqatën Bamirëse "Jetimat e Ballkanit" për t'i ndihmuar familjet në nevojë për ndërtimin e shtatë shtëpive në këtë komunë. Me këtë rast, kryetari Lladrovci ka falënderuar hoxhë Halil Kastratin, Shoqatën "Jetimat e Ballkanit" dhe gjithë donatorët për t'i ndihmuar familjet që kanë nevojë për ndërtimin e shtëpive dhe është zotuar se do t'i përmbushë të gjitha detyrimet që dalin nga kjo marrëveshje e bashkëfinancimit.

Ndërsa hoxhë Halil Kastrati ka falënderuar kryetarin Lladrovci për bashkëpunimin e treguar për t'i ndihmuar familjet të cilat kanë nevojë. Sipas kësaj marrëveshje të bashkëfinancimit, Komuna e Drenasit obligohet që për secilën shtëpi të participojë në vlerën prej 5 000 eurosh,



ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga Shoqata Bamirëse "Jetima e Ballkanit" përmes donatorëve. Pas Drenasit, Halil Kastrati nga "Jetimat e Ballkanit" ka nënshkruar një marrëveshje me kryetarin e Skenderajt për

bashkëndërtimin e pesë shtëpive për familjet në nevojë të kësaj komune. Me këtë rast, Jashari është shprehur mirënjohës ndaj humanistit Kastrati për ndihmën që gjithmonë ka ofruar për qytetarët e Komunës së



Skenderajt. "Falënderime të përzemërta për humanistin Halil Kastrati dhe Shoqatën 'Jetimat e Ballkanit' për bashkëpunimin e për shërbimin në ndihmë të popullit tonë, jetimëve dhe familjeve në nevojë", ka thënë

Jashari. Vitin e kaluar, falë bashkëpunimit në mes të Komunës së Skenderajt dhe Shoqatës "Jetimat e Ballkanit", janë ndërtuar 25 shtëpi për familjet skamnore në këtë komunë.

Lavdia u takon atyre që flijohen për vizione të mëdha (16)

Adem Jashari po bëhej gati ta niste luftën e madhe



Bedri ISLAMI

Disa herë në këtë shkrim i jemi rikthyer rrethimit të parë të Jasharëve në natën e 30 dhjetorit të vitit 1991. Ajo që ka tërhequr vëmendjen gjithnjë është bulimi i njerëzve me armë në malin bri kullave të Jasharëve, sikur e gjithë Drenica ishte shkukur aty. Ky është një fakt që dihet, por ajo që ende nuk është shpjeguar mirë qëndron në të vërtetën se si është e mundur, që në fundin e vitit 1991, ashtu papritmas, pa asnjë thirrje, në të kundërtën e asaj që predikohej në Velani, për urtësim dhe bindje, të mbledheshin në fare pak orë me qindra e mijëra burra. E pra ishte fundviti, ishte dimër, natë e ftohtë, rrugët e zëna jo vetëm nga bora, por edhe nga forcat policore e, megjithatë, pa asnjë lloj urdhri, burrat vinin të luftonin.

Kaq vite pas kësaj ngjarje duhet menduar për dy gjëra: për atë mekanizëm të jashtëzakonshëm, i cili i vë në lëvizje njerëzit, gjithnjë e më shumë drejt së panjohurës të qëndresës, drejt aktit final, luftës, si drejt një gjëje të zakonshme. Dhe e dyta, fakti që ato nuk po shkonin drejt kujtdo, sepse deri në atë kohë shumë njerëz ishin sulmuar, kishte të vrarë, kishte të burgosur, flamurë të çjerrë, mirëpo njerëzit, edhe pse kishin pasur dhimbje, në të shumtën kishin qëndruar në shtëpitë dhe vatrën e tyre.

Tani ishte vënë në lëvizje një mekanizëm tjetër, krejt i panjohur për liderët politikë legalë, i kuptueshëm vetëm për ata që e kuptonin lirinë se diçka tepër jetësore, për të cilën nuk duhen fjalë të mëdha. Por ata nuk e jepnin veten thjeshtë e rastësisht; kishin pritur një shembull të madh, një shembull që i a vllente të ecje pas tij, dhe kur e kishin gjetur, kishin filluar lëvizjen masive, ashtu si ortekët. Drenica, duke e pasur shembullin më afër se të tjerët, duke e pasur pjesë të vetes dhe bir të saj, kishte lëvizur e para. Sikur për asgjë të tjetër të mos ia kishte vlejtur kjo ditë-natë, thyerja e 30 dhjetorit dhe agimi i 31 dhjetorit, qoftë edhe vetëm për këtë fakt, ajo është e bekuar në historinë e kombit. Njerëz, mos e harroni këtë.

Rrethimi i dytë i Jasharëve ndodhi me 22 janar 1998. Përsëri dimër, natë, ftohtë përsëri, në kulla do të ndodheshin djemtë e shtëpisë, baca Shaban dhe Hamza. Ndryshe nga herët e tjera, në sulmin e 22 janarit nuk do të marrë pjesë ushtria serbe, kishte ardhur pararoja e saj. Nuk do të ketë tanke, helikopterë, por "tigrat e çartur" të kriminelit Arkan janë ata që do të marrin përsipër thyerjen e rezistencës. Në errësirën e natës, si hienat, paramilitarët e Arkanit janë shpërndarë djerve të oborrit të kullave të Jasharëve. Kanë nisur me sulmin me synimin për të djegur e vrarë gjithçka që del përpara, fëmijë apo plak qoftë, njeri apo edhe një pulë qoftë. Ata kanë tentuar të hyjnë njëherësh në shtëpi dhe në kullë. Në kullë kanë hasur në rezistencë, sepse aty ka qenë baca Shaban dhe nipat e tij, Fitimi, Besimi dhe Kushtrimi dhe të gjithë kanë pasur armë dhe kanë luftuar me serbët për më shumë se një gjysmë ore. Mund ta mendoni këtë, në njëherë anë banditë dhe kriminelë të sprovuar, dehur luftërash dhe krimesh, në kahun tjetër djem të rinj, ende pa kaluar nga fëmijëria në rininë e hershme.

Prej kullës është gjuajtur me automatikë dhe mitraloz, ndërsa Hamza, prej shtëpisë ku ka qenë, ka hedhur në drejtim të çetnikëve bomba dore, me çka serbët e shohin se kanë ndeshur në rezistencë të fortë dhe tërhiqen.

Adem Jashari nuk ndodhej asaj nate në shtëpi, sepse ishte te dajat në Llaushë, mirëpo askush nuk e ka ditur në se ishte ai apo nuk ishte brenda, pasi nipat, djemtë dhe burrat e shtëpisë bënë atë që duhej të bënin.

Rrethimi i dytë kishte ardhur pas shfaqjes së parë publike të ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, thuhet dy muaj më parë, me 28 nëntor 1997. Pas fjalëve kishte ardhur koha e pushkës. Njerëzit e kishin dëgjuar fjalën e tre drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe, megjithëse ishin tubuar për një rast të dhimbshëm, si ishte vrasja e mësuesit Halit Geci, ishin ngritur në këmbë dhe në përjashtim nga çdo rregull, kishin duartrokitur, kishin thirrur, kishin brohoritur. Kishte ndodhur diçka e re, e jashtëzakonshme për mendimin politik, krejt të ndryshkur, për të thënë butë kështu, në Prishtinë; kishte qenë një akt jo vetëm miratimi, por edhe mbështetje. Ndaj dita e 22 janarit 1998 ishte

vazhdimi i asaj që kishte ndodhur me 28 nëntor. Ishte momenti kur po "drenicohej" Kosova, në se mund të them kështu, dhe fakti, se vetëm gjashtë javë më pas do të kemi njëherësh tri qendra të tjera të mëdha luftime, Dukagjinit, Llapin dhe Shalën dëshmon se fara e hedhur në betejën e 22 janarit kishte qenë e frytshme.

Pas kësaj dite shqiptarët e kuptuan se lufta ishte e domosdoshme, se ajo ishte në prag dhe se nuk kishte asnjë rrugë tjetër. Njeriu që ishte vënë në krye të atyre që kishin vendosur të luftonin tashmë u ishte përgjigjur të gjitha dyshimeve dhe pyetjeve të lodhshme: "A mund të luftohet me Serbinë", "A do ja dalim", "deri ku mund të shkojmë", etj etj. Ndryshe nga sa do të thoshte çdo ditë të premtë në konferencat e lodhshme të shtypit njeriu i vetmuar i Velanisë se, "Kosova në një luftë me Serbinë nuk mund të qëndrojë as dy tri ditë", njeriu i heshtur, Adem Jashari, kishte bërë deri me 22 janar vetëm "dy konferenca", të dyja me armët që kishte ai dhe shokët e tij, dhe të dyja e kishin zgjuar popullin e Kosovës më shumë se miliona fjalë të pabukshme.

Pas 22 janarit, të dyja palët, sepse tashti ishin dy palë si në çdo luftë, mendojnë e ka ardhur koha e ditës së fundme: serbët mendojnë se ka ardhur koha e ditës së fundme të Adem Jasharit dhe me këtë do të shkatërrohet e gjithë ngrehina e ngritur prej tij, Ushtria Çlirimtare e Kosovës; Adem Jashari mendon se ka ardhur dita e fundme e pushtimit serb të Kosovës. Janë dy llogaritë të ndryshme, të cilat, dashje pa dashje, duke qenë jo vetëm të ndryshme, por edhe thelbësisht të kundërta, do të sillnin patjetër një ditë tjetër. Cila do të ishte ajo?

Serbia po bënte gati rreth 5 000 trupa elitë për rrethimin e madh, të tretin të Jasharëve. Adem Jashari po bëhej gati të niste luftën e madhe. Serbia thirrej e çirrej se këtu kishte qenë djepi i saj, Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk kërkonte asgjë më shumë se sa të gjitha popujt e botës: mëvetësinë në trojet e veta, shtetin e tyre, bashkimin e kombit. Ishte një dëshirë tejet fisnike e njerëzore, të cilën mund ta sjellin vetëm ata që janë të denjë për t'u flijuar në emër të saj.

Nëse do të kishte qenë vetëm

kaq, gjërat do të ishin shumë më lehtë. Në skenën politike të Kosovës do të shfaqeshin, herë denjësisht dhe herë mjerueshëm, dy skaje, të cilat, sado që do të përpiqeshin vite më vonë t'i paraqitnin në një të vetme, nuk do të ishin ashtu.

Koha do të provonte se dy njerëzit që ishin në dy skajet e një litari do të kishin filozofi të ndryshme politike, vizione të ndryshme, burrimi të ndryshme. Njëri nga Velania, mbështjellë pas shallit, do të predikonte heshtjen, durimin, përluljen dhe kur do të vinte një ditë e ardhshme, do i bënte thirrje të gjithëve të nënshtroheshin, të ndaloheshin bombardimet, pasi familja e tij, gjoja e kidnapuar, ishte në rrezik. Tjetri do të bënte thirrje për qëndresë, për ringritje, për ruajtjen e emrit dhe të identitetit, për shpalljen e flamurit, i gatshëm të vetëflijohej, jo fillikat, por me të gjithë njerëzit e tij. Njëri do të përpiqej të sillte në politikën shqiptare teorinë e "mos kundërshtimit të se keqes me dhunë", tjetri do të bënte të veten thënien e famshme të Jusuf Gërvallës "në ballë të këtij populli dhe në ballë të tij vdekja do na vijë si përjetimi më i bukur i jetës simë". (Fund)



Përhapja e infektimit me Covid-19 në Evropë alarmon OBSH-në

NJU JORK, 25 QERSHOR - Evropa është duke u përballur me rritje të numrit të rasteve me koronavirus për herë të parë në disa muaj, ndërkohë që janë lehtësuar masat e kufizimit, të vëna me qëllim të luftimit të sëmundjes Covid-19, që shkakton ky virus, ka thënë Organizata

Botërore e Shëndetësisë. Në 11 shtete, të cilat nuk janë emëruar, përhapja e virusit ka ndikuar në rritje të madhe të të infektuarve, ka thënë drejtori rajonal i kësaj organizate, Hans Henri Kluge. Ai ka thënë se paralajmërimet e tij për rritje të numrit të rasteve tani janë kthyer në realitet.

Nëse Covid-19 nuk kontrollohet, ai beson se sistemet shëndetësore do të përballen me vështirësi. Në zonën që kontrollon OBSH-ja në rajonin evropian, përkatësisht Evropë, Lindje e Mesme dhe Azi Qendrore, deri më tani janë konfirmuar 2.6 milionë persona të infektuar,

derisa 195 000 prej tyre kanë vdekur. Aktualisht rreth 20 000 raste të reja dhe 700 vdekje po raportohen në baza ditore. Kluge ka thënë se shtetet si Polonia, Gjermania, Spanja dhe Izraeli janë përgjigjur shpejt ndaj shpërthimeve të rrezikshme, të lidhura me



shkollat, minierat e qymyrit dhe fabrikat e përpunimit të ushqimit, duke vënë situatën nën kontroll.

Policia malazeze arreston dhjetëra protestues pro-serbë

PODGORICË, 25 QERSHOR - Policia malazeze ka arrestuar dhjetëra njerëz pas disa tubimeve pro-serbe në Podgoricë dhe qytete të tjera. Tubimet u thirrën nga zyrtarë të opozitës, të cilët përkrahin lidhjet më të ngushta me Serbinë dhe Rusinë.

Protestat e 24 qershorit reflektojnë tensionet politike në Mal të Zi përpara zgjedhjeve parlamentare të planifikuara për 30 gusht.

Protestat shpërthyen në qytetin bregdetar, Budvë, ku tensionet kanë qenë të larta për shkak të një mosmarrëveshje midis autoriteteve komunale.

Policia përdori gaz lotsjellës

për t'i shpërndarë demonstruesit dhe arrestoi 17 persona. Në kryeqytetin Podgoricë policia tha se 18 protestues u arrestuan.

Autoritetet thonë se dhjetëra protestues të tjerë u arrestuan në pjesë të vendeve të tjera.

Tensionet në Budva filluan më 17 qershor, kur kryetari Marko Careviq, i cili është besnik i opozitës pro-serbe të Malit të Zi, nuk pranoi t'ia dorëzonte pushtetin koalicionit qeverisës, pasi humbi kontrollin e shumicës në asamblenë lokale. Në fillim të këtij viti, Kisha Ortodokse Serbe zhvilloi për javë të tëra protesta në Mal të Zi kundër një ligji për fetë. Krerët e kishës



pretenduan se përmes atij ligji ata do t'i humbnin pronat.

Ky ligj hyri në fuqi në janar. Ligji thotë se bashkësitë fetare duhet ta dëshmojnë pronësinë e tyre para vitit 1918 - vitin kur

Mal i Zi u bashkua me Mbretërinë e Jugosllavisë dhe kisha e saj iu bashkua Kishës Ortodokse Serbe, duke humbur të gjithë pronën e saj. Kisha Ortodokse Serbe thotë se ligji ka

për qëllim rimarrjen e pronave të saj. Zyrtarët malazezë e kanë mohuar vazhdimisht akuzën.

Mali i Zi u nda nga Serbia në një referendum të vitit 2006. Ajo më tej është distancuar nga Beogradi dhe aleatja e saj ortodokse, Rusia, që nga ajo kohë, duke marrë një kurs të politikës së jashtme pro-perëndimore dhe anëtarësimin në NATO më 2017. Mali i Zi, gjithashtu, ka qenë duke negociuar hapa drejt anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Nacionalistët serbë në Mal të Zi dhe Serbi kurrë nuk e kanë njohur plotësisht ndarjen e Serbisë nga Mali i Zi, për të cilin ata pretendojnë se është një territor historik serb.

Në ShBA vazhdon rritja e numrit të personave me Covid-19

NJU JORK, 25 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara kanë shënuar rritje të numrit të të infektuarve me Covid-19. Më 24 qershor u shënuan 34 700 raste të reja. Kjo është shifra më e lartë që nga muaji prill.

ShBA-ja ka zgjeruar shkallën e testimit, por zyrtarët janë të shqetësuar me shifrat e reja, pasi numri i të infektuarve kishte një tendencë të rënies në muajin e fundit.

Gubernatori i Teksasit u bëri thirrje njerëzve që të qëndrojnë në shtëpi sepse shteti po përballlet me një "shpërthim masiv" të virusit, ndërsa guvernatori i Arizonës u bëri



thirrje njerëzve të vendosin maska.

Në Teksas, guvernatori Greg Abbott tha se mund të ketë

nevojë për kufizime të reja lokale për të mos u ngarkuar spitalet me pacientë.

Kalifornia më 24 qershor raportoi

më shumë se 7 000 raste të reja në një periudhë 24-orëshe, një rritje prej 25 përqindësh në krahasim me rekordin e vendosur javën e kaluar.

Shtetet amerikane, Nju Jork, Nju Xhersi dhe Konektikat, do t'u kërkojnë vizitorëve nga qendrat e përhapjes së koronavirusit që ta zbatojnë masën e karantinës 14-ditore, kanë thënë zyrtarët.

Gubernatorët e këtyre tri shteteve që më parë kanë qenë vetë qendra të përhapjes së këtij virusi kanë bërë të ditura masat e reja ditën e mërkurë.

Gubernatori i Nju Jorkut, Andrew Cuomo, ka thënë se nuk dëshiron që vizitorët e vendeve të tjera ta

dërgojnë koronavirusin në vendin që ai udhëheq, pasi është punuar shumë për ta ulur shkallën e transmetimit të virusit. Rregulla e karantinës do të aplikohet për shtete ku 10 përqind e popullsisë është e infektuar me koronavirus, duke marrë parasysh një mesatare shtatëditore, ka thënë Cuomo. Nëntë shtete, duke përfshirë Allabaman, Arkansasin, Arizonan, Floridan, Karolinën Veriore, Uashingtonin, Utah dhe Teksasin, aktualisht janë të prekura me shkallën e përmendur të infektimit. Masa e karantinës është thënë se do të nisë së zbatuari ditën e enjte.

Kuvendi demokrat përmes platformave digjitale

UASHINGTON, 25 QERSHOR - Pandemia, ka detyruar demokratët në ShBA të ndërmarrin hapin historik të zhvillimit të kuvendit të tyre partiak përmes platformës digjitale. Komiteti për Kuvendin Demokratik Kombëtar ka njoftuar për këtë vendim, duke thënë se delegacionet shtetërore nuk do të mbledhen në Miuaqi. Megjithatë, ky qytet

organizator do të shërbejë si qendra e transmetimeve të drejtpërdrejta për katër ditët e kuvendit, por do të ketë edhe aktivitete të tjera nga qytete dhe objekte të ndryshme në vend. Pjesa më e madhe e punës që zakonisht kërkon grumbullimin e zyrtarëve partiakë nga çdo cep i vendit këtë radhë do të zhvillohet si sesione pune përmes lidhjes online. Duke

qenë se aktiviteti nuk do të shoqërohet me grumbullimin e turmave entuziaste në një mjedis, duke brohoritur dhe duke ndjekur fjalimet, organizatorët kanë vendosur ta zhvendosin kuvendin nga pallati i sportit ku luan ekipi i basketbollit, Milwaukee Bucks. Tani aktiviteti do të zhvillohet në qendrën e kuvendeve të Miuaqit.



“BECOMING”, NJË PËRVOJË E PASUR NË SHËRBIM TË IDEVE TË LARTA



Lulëzim ETEMAJ

Libri autobiografik i ish-Zonjës së Parë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (2009-2017), Michelle Obama, “Becoming” (“Të bëhesh”), ka dalë nga shtypi më 13 nëntor 2018 njëkohësisht në 24 gjuhë. Mbi 60 milionë dollarë është çmimi që botuesi “Penguin Random House” ua ka paguar për këtë libër Michelle dhe Barack Obamës.

Shitja e tij, prej mbi dhjetë milionë ekzemplarë si dhe përkthimi më pastaj edhe në gjuhë të tjera, përfshirë edhe gjuhën shqipe, e ka legjitimuar shumë pritjen paraprake dhe interesimin e lartë të treguar prej lexuesve jo vetëm në ShBA, por edhe në shumë shtete të botës. Si rrjedhojë, “Becoming” ia ka arritur të bëhet një bestseller i vërtetë.

Michelle Robinson është femija i dytë, krahas vëllait Craig, i çiftit bashkëshortor Fraser dhe Marian Robinson. Thotë se nga babai ka mësuar të punojë

shumë, të qeshë shumë dhe ta mbajë gjithnjë fjalën. Ndërsa se si mund të mendojë me kokën e saj dhe ta angazhojë zërin e saj, ka mësuar nga e ëma. Që të dy së bashku, njëherësh thotë t'i kenë ndihmuar në banesën e tyre të ngushtë në Anën Jugore të Chicagos “t'i njohë vlerat e historisë sonë, historisë sime, në historinë e madhe të vendit tonë”.

Përmes librit të saj “Becoming”, Zonja e Parë e ShBA-së, Michelle Obama, ia ka dalë të hyjë në mjediset e miliona familjeve në botë. Për më tepër, ajo është gruaja e vetme afro-amerikane që ka shënuar një depërtim të tillë. Prejardhja e saj nga një familje sklave, e bën edhe më të bujshme dhe e begaton me vlera të posaçme jo vetëm historinë e familjeve presidenciale, por edhe të vetë ShBA-së.

Duke pasur shumë se çka t'i rrëfej lexuesit, ish-Zonja e Parë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, avokate me profesion, librin e hap me paraqitjen e gjenezës së saj familjare. Fëmijëria; ëndrrat dhe dëshirat fëmijërore; shkollimi; karriera profesionale; dashuria dhe martesja me Barack Obamën, janë sjellë prej saj në libër me një gjuhë dhe stil të veçantë, të


rrjedhshëm, lehtë të kuptueshëm, që flet për shijen e hollë që e karakterizon rrëfimin. Ballafaqimi i hershëm me diskriminimin racor, shkaku i ngjyrës së lëkurës dhe prejardhjes, do të ketë ndikim të fuqishëm te Michelle Obama në angazhimet shumëdimensionale për barazi sociale, gjinore dhe tejkallim të ndasive dhe padrejtësive raciale. Një angazhim i tillë i fuqishëm manifestohet posaçërisht me rastin e kandidimit të bashkëshortit të saj për president, Barack Obama, dhe fushatës presidenciale të vitit 2008, si kandidat demokrat, ku Michelle Obama me ekipin e saj zgjedhor ia arrinë t'i motivojnë fuqishëm votuesit me prejardhje afro-amerikane për të dalë në zgjedhje dhe dhënë votën e tyre.

Duke qenë luftëtare e madhe kundër çdo pabarazie dhe diskriminimi, Michelle Obama shndërrohet shumë shpejt në ikonë jo vetëm për shumë femra në ShBA, por edhe përtej saj.

Me emocione të theksuara ajo rrëfen në libër momentin kur presidenti Obama në Zyrën Ovale në Shtëpinë e Bardhë e zëvendëson bustin e Winston Churchillit me atë të Martin Luther Kingut, autorit të fjalimit të famshëm historik “I have a dream” (“Unë kam një ëndërr”), përmes të cilit ai më 28 gusht 1963, në marshin protestues të mbi 250 pjesëmarrësve në Washington D. C., i kërkonte SHBA-së që t'i japë fund diskriminimit racor.

Pavarësisht faktit se të qenët Zonjë e Parë në ShBA nuk është as profesion dhe as post zyrtar, madje ajo nuk merr as rrogë dhe nuk iu nënshtrohet detyrimeve të posaçme, në funksion të vizionit politik të saj dhe bashkëshortit, tanimë presidentit Obama, Michelle Obama ia arrin shumë shpejt që në cilësinë e Zonjës së Parë ta shndërrojë Shtëpinë e Bardhë në një shtëpi mikpritëse, promovuese të gjithëpërfshirjes gjinore dhe racore.

Duke qëndruar shumë pranë bashkëshortit, presidentit Obama, sipas rrëfimit të saj, ajo ia ka arritur me sukses jo vetëm të jetë mbështetëse e tij e fuqishme në situata të shumta, por t'i bëjë edhe pjesë të angazhimit të tij të drejtat e miliona femrave jo vetëm në ShBA.



Pjesë e veçantë e rrëfimit në libër është edhe angazhimi i saj i pakursyer, edhe gjatë dy mandateve si Zonjë e Parë, për t'u dhuruar kujdesin e merituar dhe rritur dy vajzat e tyre, Malia dhe Sasha.

Michelle Obama në librin e saj autobiografik i rrëfen lexuesit një mori përvojash jetësore nga jeta e saj, duke mos anashkaluar edhe dështimet dhe zhgënjimet e caktuara si nga jeta personale, po ashtu dhe ajo publike. Me një ngrohtësi, identifikim dhe pasion të posaçëm ajo rrëfen për fushatat e shumta të iniciuara prej saj, në bashkëpunim me presidentin Obama, personalitete të caktuara, shoqata apo dhe grupe të ndryshme. Në këtë mënyrë ajo ia ka ofruar mundësinë lexuesit që të njihet së afërmi edhe me angazhimin dhe sfidat e saj në fushatën për përdorimin e perimeve, me qëllim luftimi të mbipeshës te fëmijët dhe të rinjtë; nga takimet e ndërmarra dhe bashkëpunimin me industrinë ushqimore për ta zvogëluar sasinë e sheqerit në ushqime; për grumbullimin dhe investimin e miliarda dollarëve në gjithë botën në funksion të shkollimit të vajzave; për hapjen, së

bashku me Jill Biden, dhe sipërmarrës të shumtë, të 1.5 milion vendeve të reja të punës për veteranët e luftës apo sigurimin e një vendshkollimi për pjesëtarët e familjeve të tyre.

“BECOMING”, si një jetëshkrim intim, nga të rrallët të shkruar nga zonjat e para, do të mbetet për një kohë të gjatë një nga librat më të lexuar. Historia e ish-Zonjës së Parë të ShBA-së, Michelle Obama, e bërë publike përmes këtij libri, do të jetë për gjenerata të tëra lexuesish një referencë e fuqishme frymëzimi në angazhimet e tyre kundër padrejtësisë si dhe në luftimin e diskriminimit, si gjinor ashtu dhe racor, në të gjithë botën. Në këtë drejtim, jetëshkrimi i përmbledhur në libër nga Michelle Obama shkon përtej modës së të shkruarit të autobiografive nga personalitete të larta publike dhe tërheqjes së dritave të projektorëve drejt vetes.

Libri “BECOMING” reflekton në radhë të parë vazhdimin e misionit të ish-Zonjës së Parë, Michelle Obama, në funksion të barazisë dhe zhvillimit të përgjithshëm, jo vetëm të vendit të saj, ShBA-së, pa pretendimin për të pasur ndonjë post shtetëror.



E rrallë

Në Rusi zbulohet objekti 2 137-vjeçar, ngjan me një celular

Një lloj telefoni i jashtëzakonshëm 2 137-vjeçar është gërmuar nga një varr i një gruaje të re në një Atlantis në Rusi. E pasionuara pas modës e lashtësisë e epokës Xiongnu është quajtur Natasha nga arkeologët dhe varri i saj u gjet gjatë një kullimi të një rezervuari të gjerë të bërë nga njerëzit në Siberi. Në fakt, telefoni celular është bërë nga lloje të



ndryshme gurësh të çmuar disa ngjyrësh. Arkeologu Dr. Pavel Leus tha: "Varrimi i Natashës me një telefon celular të epokës Hunnu (Xiongnu) mbetet një nga zbulimet më interesantet në këtë vend varrosjeje".

FOTO E DITES




Një zog në Gjermani shihet në pasqyrën e makinës. /AFP/

E jashtëzakonshme

Futën letra sekrete në mur kur ishin fëmijë, gruaja shpërthen në lot kur i gjen pas 30 vjetësh

Kimberley Colbeck, 36-vjeçare, ka shpërthyer në lot pasi ka zbuluar disa shkrime sekrete që ajo ka shkruar së bashku me motrën dhe vëllanë e saj në vitin 1987 dhe i kishin fshehur në një mur të shtëpisë së tyre të vjetër. Një ndërtues që po mer-



reshe me rikonstruktimin e shtëpisë ka gjetur letra të shkruara 30 vjet më parë nga tre fëmijët e familjes Andrew 13-vjeçar, Christopher 8-vjeçar dhe Kimberley, e cila ishte vetëm trevjeçare. Kimberley, e emocionuar nga këto gjetje, i ka publikuar në "Facebook".

BARSOLETA E DITËS



- Alo! Me kryeministrin po flas?
- Po. Çfarë mund t'ju ndihmoj?
- Dua të kandidoja për kryeministër. Cilat janë kushtet?
- Je i çmendur?!
- Kushte të tjera, a ka?



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

Rita Ora provokon ndjekësit në Twitter: Nuk mund t'i gjej bikinit e mia

Rita Ora ka provokuar ndjekësit me fotografitë e fundit që ka publikuar. E veshur në të brendshme në pjesën e sipërme, këngëtarja ka marrë vëmendje.

Rita shihet e ulur në karrige ndërsa në pjesën e poshtme nuk të veshur asgjë vetëm pantolla të shkurt. 'Nuk mund t'i gjej bikinit e mia', ka shkruar ajo.



 <p>DASHI Keni ende shumë gjëra për të bërë, sidomos në aspektin personal. Në ditët në vazhdim do të jeni shumë i zënë.</p>	 <p>DEMI Do të jetë një ditë relaksimi dhe reflektimi për ju. Nëse kishit bërë një listë se çfarë duhet të bëni e çfarë jo, nesër është dita për t'i parë gjërat që keni lënë pas dore.</p>	 <p>BINJAKËT Duhet të keni durim dhe shumë dëshirë për t'i rregulluar të gjitha problemet që keni pasur në jetën në çift.</p>	 <p>GAFORRJA Dukeni mjaft të shqetësuar e të tensionuar por, në fakt, nuk jeni të mërzitur me askënd. Sigurisht nuk mund ta neglizhoni si të parëndësishme.</p>	 <p>LUANI Që në mëngjes keni për të vënë re se dita do të jetë shumë e ngadaltë dhe do të keni frikë se mos nuk përfundoni dot planet.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Në këtë ditë çdo gjë do të duket dhe mund të merrni e të shprehni shumë dashuri. Për një moment do t'ju duket vetja qesharak.</p>
 <p>PESHORJA Jeni shumë nervoz dhe në pamje të parë i frikësoni të tjerët. Duhet të hapeni me persona të besuar dhe ta shkarkoni stresin që keni.</p>	 <p>AKREPI Në përgjithësi pritjet një ditë e mirë dhe e vetmja gjë që do t'ju bëjë të jeni në dilemë është se do të keni më shumë se një alternativë për të zgjedhur.</p>	 <p>SHIGJETARI Do të keni kohë të lirë për t'ua dedikuar atyre gjërave që zakonisht ua lini të tjerëve për t'i përfunduar. Kjo do t'ju krijojë mundësi për afirmite të reja që s'i prisnit.</p>	 <p>BRICJAPI Keni nevojë për më shumë kohë për t'i rregulluar situatat e komplikuara që jua ka sjellë jeta. Prandaj merreni më me qetësi.</p>	 <p>UJORI Keni gjetur disa gjëra në lidhje me një person që është shumë afër dhe se mund të jetë një problem.</p>	 <p>PESHQIT Të gjitha ambiciet tuaja në këtë kohë mund të jenë të pakëndshme për njerëzit që ju duan dhe të cilët do të donin t'u shihnin më të fokusuar në diçka për shoqërinë sesa vetëm për veten.</p>

Me një foto nga prapaskenat, Ledri zbulon datën e publikimit të këngës 'Aman'



Ledri Vula së bashku me Dafina Zeqirin ka ndarë të njëjtin postim në profilet e tyre në "Instagram" për të njoftuar rreth datës së publikimit të këngës. Kënga e cila mban titullin 'Aman' do të prezantohet


para publikut më 1 korrik dhe është e kompletuar edhe nga ana vizuale. Vlen të përmendet që për herë të parë Ledri, Duffy dhe Lumi bëhen bashkë për të njëjtin projekt, ndonëse më parë kishin duete mes vete.

Çiljeta Xhilaga po vjen me bashkëpunim



Së shpejti do të publikohet projekti më i ri muzikor nga Çiljeta Xhilaga. "M'ke harru" do të titullohet kënga për të cilën ajo ka bashkuar idetë me një femër dhe fjala është për vajzën

që quhet Marsi. Kjo e fundit ka ndarë një fotografi në "Instagram" duke njoftuar se kënga e re me titull "M'ke harru" vjen së shpejti pasi edhe xhirimet e klipit kanë përfunduar.



Georgina pozon në jahtin luksoz të Ronaldos

Partnerja e Ronaldos, Georgina Rodriguez, po e shijon në maksimum jetën luksoze që po i ofron ai. Me veshje të shtrenjtë e sportive, ajo po relaksohet në maksimum në jahtin e Ronaldos, ndërsa bien në dy çorapet që kapin çmimin 140 funte (154 euro). Pantallonat e

shkurtra të Georginës kushtojnë rreth 510 funte (564 euro), këpucët e saj rreth 705 funte (780 euro) dhe xhaketat 1 210 funte (1339 euro). Totali i kësaj paraqitje shkon në 2565 funte (2840 euro). Kjo foto u publikua pasi doli çmimi super i shtrenjtë i orës së dorës së Cristiano Ronaldos.

Demi Lovato uron ditëlindjen e të dashurit me një fotografi intime



Demi Lovato dhe Max Ehrich kishin mbajtur të fshehtë dashurinë për disa muaj, derisa këngëtarja gjatë një video 'live' kishte zbuluar rastësisht lidhjen. Ajo u kyç të mërkurën në "Instagram" për të ndarë një urim për aktorin amerikan i cili ka mbushur 29 vjet jetë. Në postimin plot dashuri, Demi atribuoi të dashurin që

ka bërë atë të ndihet e dashur dhe e pranuar pa kushte, në një mënyrë që nuk është ndier kurrë më parë. "Unë nuk mund ta sqaroj atë as ty. Ti je i papërshkrueshëm, o burrë i bukur. Brenda dhe jashtë jeni të mrekullueshëm", ka shkruar Demi, e cila është duke u karantinuar me Max në shtëpinë e saj në Los Anxhelos.

Botohet monografia Drama kombëtare në vitet 1950-1975

Profesoresha në Fakultetin e Arteve Dramatike të Universitetit të Prishtinës, Seadet Beqiri, ka botuar këtë javë librin monografik Drama kombëtare në vitet 1950-1975 nën përkujdesjen e shtëpisë botuese “Armagedoni”.

Sipas recensentit Haqif Mulliqi, *Drama kombëtare në vitet 1950-1975* paraqet kontribut të vyer në fushën e studimeve dramaturgjike shqiptare të krijuara gjatë periudhës së realizmit socialist në Shqipëri. “Përqendrimi i autores në këtë tekst bëhet në periudhën më të rëndësishme të dramës në kuptimin e konsolidimit të kësaj krijimtarie letrare sipas termave të realizmit të përcaktuar nga ideologjia politike, synimi përfundimtar i së cilës ishte krijimi i një formacioni stilistik letrar dhe artistik, i një poetike të veçantë me motivacionin për krijimin e modelit të qenies politike – njeriut të ri, heroit që do të ishte në shërbim të doktrinës së partisë dhe të shtetit”.

Ndërsa sipas recensentit Meliza Krasniqi, “*Drama kombëtare në vitet 1950-1975* objekt analize ka 75 drama, të cilat në pjesën më të madhe i karakterizon poetika e realizmit socialist. Në rrafshin e kërkimit është përdorur metodologjia e leximit tematik, me të cilën Beqiri propozon klasifikimin e dramave në pesë grupe të mëdha, në: dramë historike, dramë e propagandës, dramë familjare dhe e emancipimit shoqëror, dramë jashtë kornizës së përcaktuar dhe komedi e satirë. Dy llojet e fundit të dramës lidhen me esenca të tjera. E para është klasifikuar sipas ‘kriterit përjashtues’, e dyta sipas zhanrit. Beqiri në këtë libër ua ofron lexuesve një pjesë të rëndësishme të dramaturgjisë kombëtare shqiptare, kurse studiuesve një qasje shtesë dhe tjetër shkencore”.


Shënime për autoren
Seadet Beqiri përfundoi studimet Ba dhe Ma në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës – drejtimi Dramaturgjia, kurse studimet e doktoratës në Universitetin e Tiranës – dega Letërsi shqipe. Ka shkruar drama të zhanreve të ndryshme, si: *Dolcinius, Trilogji hajdutësh, Kush është, E kaluara takon të ardhmen, Histori e harruar, Sekretet e urës, Anima Mea*, monodramën *Shumë urime për ty*, dramën për fëmijë *Babadimri në Kosovë* si dhe radiodrama kushtuar figurave të historisë kombëtare. Disa prej veprave të sipërpërmendura janë botuar dhe janë vënë në skenë në teatrot vendore. Ndërkaq, prej skenarëve të saj

veçohet ai për serialin *Lexi në qytet* (transmetuar në RTK). Beqiri ka dramatizuar edhe veprat *Fizikanët* të F. Dyremont (TKK), *Të jetosh në ishull* të B. Blushit (FA), *Bretkosa* të D. Mihanoviçit (Teatrin AAB) si dhe *Bryma e vdekjes* të M. Krasniqit (TKK).

Aktualisht mban titullin profesor asistent në Fakultetin e Arteve të Prishtinës.

Parathënia e librit *Drama kombëtare në vitet 1950-1975*

Përvojat e para të dramës kombëtare shqiptare vijnë nga letërsia arbëreshe. *Numidët* e Jeronim de Radës, shkruar më 1846 e botuar shumë më vonë në gjuhën italiane (1891), me titullin *Sofonisba*; *Ines de Castro* e Anxhelo Baziles botuar po në gjuhën italiane më 1847 dhe *Francesca da Rimini* e Gavril Darës botuar pjesërisht në vitin 1921, nga studiuesit do të konsideroheshin si fenomene ndërkulturore,^[1] pa mundur të futeshin në fondin e dramave shqipe, duke ia lënë nderin *Emirës* (1885) së Anton Sartorit që të klasifikohet si drama e parë shqipe. Një dukuri që u vu re në aktivitetin artistik shqiptar të kësaj periudhe ishte edhe përshtatja e modeleve të dramës klasice, e cila ishte kthyer në një praktikë krijuese në mesin e shkrimtarëve të gjysmës së parë të shekullit XX. Edhe në dramë, ashtu si në të gjitha gjinitë letrare të lëvruara në periudhën e Rilindjes, ndihet i fuqishëm karakteri kombëtar. Funkcioni i dramës në këtë aspekt duhet parë si sukses pasi solli karakteristika të mjedisit dhe pasqyrim të drejtpërdrejtë të gjendjes së popullsisë shqiptare. Vitet ‘30 shënuan një fazë të re për letërsinë shqipe. Studiuesit flasin për një zhvillim cilësor të saj. Autorë të rinj si Etëhem Axhiademi, Haki Stërmilli, Foqion Postoli sollën një frymë të re në këtë gjini. “Nga pikëpamja formale dhe e strukturës ndërtimore të ligjërit, Haxhiademi, Fishta, Floqi, Grameno, Çajupi parapëlqejnë tipin neoklasik të tragjedisë të thurur në vargje. Kjo qe një strukturë unike dhe e pazëvendësueshme e tragjedisë antike klasike greke me emrat e famshëm të Eskilit, Sofokliut, Euripidit, sikundër edhe asaj romake me Knej Nevin, Liv Andronikun dhe treshen e mirënjohur Kuin Enin, Mark



Pakuvin, Luc Atin (të krahasueshëm me Eskilin, Sofokliun dhe Euripidin), veçanërisht me tragjeditë e Senekës, gjer te drama romantike (për shembull Bajroni, Shelli, Gëtja, Shileri), e përdorur shpesh nga autorët romantikë, ku gërshetohen emocione dhe pësjtjellime psikike që shkojnë deri në zgrip, me arsytimit të tipit iluminist” vëren dr. Emin Z. Emiri në studimin e vet monografik “Neoklasicismi në dramaturgjinë shqiptare”.

Megjithatë, në shumicën e rasteve krijimet dramatike nuk sollën ndonjë përparim qoftë në aspektin strukturor qoftë në aspektin tekstual. Dobësitë e kësaj krijimtarie, e cila përcillte sentimentalizmin postromantik, nuk arritën t’i tejkalonin problematikën në ndërtimin e karaktereve e, rrjedhimisht, edhe në ndërtimin e dialogëve, fabulës apo edhe të anës kompozicionale të saj. Drama kombëtare e bëri hapin më të sigurt, në kuptim strukturor, me dy veprat e Kolë Jakovës *Halili dhe Hajrija* (1950) dhe *Toka jonë* (1954). Në fund të viteve ‘50 drama kombëtare vazhdoi pasurimin e vet me autorë si Spiro Çomora, Ndreka Luca, Dionis Bubani, Vangjush Ziko, Naum Prifti, Dritëro Agolli, Loni Papa, Fatos Arapi, Sulejman Pitarka, Minush Jero, Qamil Buxheli dhe shumë të tjerë, veprat e të cilëve do t’i trajtojmë në vazhdim.

Ajo që hetohet në këto zhvillime është se nga një letërsi e angazhuar për zgjimin kombëtar, në vitet e pas Luftës Nacional Çlirimtare u shndërrua në një letërsi të ndikuar nga lëvizja punëtore që ndërtoi grupet e para komuniste për ta përhapur doktrinën socialiste nëpërmjet artit në përgjithësi, e sidomos dramës. Dramaturgjia e realizmit socialist mbeti e veçuar nga tradita dhe kodi letrar gjenetik nacional, e shpëputur edhe nga përvoja krijuese evropiane dhe botërore, e cila ndonjëherë jo vetëm se u anashkalua, por edhe u injorua, u harrua e u mohua. Pavarësisht prej këtij fakti, “kun-

drimi i pjesshëm i trashëgimisë sonë letrare dëmton njësoj si autorët a grupet e autorëve të anashkaluar, ashtu edhe autorët a grupet e sforcuara, duke ofruar, në vend të një tërësie funksionale të procesit letrar, një torzo eksperimentale që, në fund të fundit, nuk është gjë tjetër veçse një trajtë e shtrembëruar e identitetit tonë kombëtar”^[2]. Në periudhën e realizmit socialist, një pjesë e autorëve dhe veprave të tyre, pavarësisht se u përpoqën të zhvilloheshin brenda koncepteve krijuese të metodës, mbetën jashtë vëmendjes së duhur për arsye dhe shkaqe nga më të ndryshmet, me përjashtim kur ata, përkatësisht vepra e tyre, binte ndesh me parimet e realizmit socialist. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe u ndërtua një lloj mendësisë së re krijuese e cila kërkonte nga artistët, nga shkrimtarët dhe dramaturgët, të trajtohen tema me motive të luftës çlirimtare sepse “çlirimi i vendit dhe vendosja e rendit shoqëror që udhëhiqet nga filozofia e veprimit revolucionar kërkonte që edhe njeriu i këtij rendi të ishte në veprim të vazhdueshëm revolucionar. Kjo jetë e re ishte jetë e punës, e luftës dhe veprimtarisë së gjallë materiale dhe morale të të gjitha masave punonjëse”^[3]. Ajo që e karakterizoi këtë ndarje apo shpëputje të panatyrshme, jo vetëm të dramës, por edhe të letërsisë në përgjithësi, ishte pikërisht ndarja e saj nga tradita për t’i mësuar krijuesit me metodat e realizmit socialist.

Metoda e realizmit socialist u glorifikua deri në atë shkallë sa që ajo mohonte vlerat paraprakisht të krijuara artistike jo vetëm në shtetin socialist të Shqipërisë, por edhe kudo tjetër në botë sepse “epoka e socializmit, e vetmja epokë ku vlerat dhe e vërteta, të krijuara nga njerëzimi, mund të vihen plotësisht në shërbim të tij dhe progresit, për herë të parë në historinë e mendimit dhe të kulturës shqiptare, nxori në dritë të plotë visaret e trashëgimit kulturor që populli ynë ka krijuar me

shkruar”^[4].

Botime monografike mbi historinë e dramës shqipe janë sjellë nga autorët si: dr. N. Islami, *Historia dhe poetika e dramës shqiptare: (1886-1996)*, V- 1, 2 si dhe, dr. B. Rexhaj, *Drama shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore (1948-2008)* V-1, 2. Por, kjo monografi është e fokusuar në 75 drama të botuara brenda viteve më dramatike 1950-1975. Evidentimi i këtyre dramave është bërë nga *Bibliografia e dramës së botuar shqipe (1883-2017)* nga dr. Erenestina Gjergji-Halili dhe Msc. Orland Novaku^[5], ndërsa aspekti kërkimor dhe hulumtues është bazuar në botimet e dramave si të veçanta apo në kuadër të revistës “Nëndori”. Këto drama të përmbledhura shpalosen në formë të syziut dhe me paraqitje të personazheve dhe rrethanave në të cilat ato jetojnë dhe vepron.

Qëllimi i sjelljes së këtyre veprave është ekskluzivisht njohja e lexuesit me dramaturgjinë kombëtare të kësaj periudhe. Prurja e tyre në një numër të konsiderueshëm shpeshojmë të ngjallë interesim dhe dëshirë që ky studim mos të mbetet në këto përmasa, por që në të ardhmen të shfrytëzohet si bazë për studime të mëtutjeshme dhe sidomos për studiuesit e rinj. Është më se e evidente se letërsia e kësaj periudhe lë hapësirë për studim të vazhdueshëm “jo në shkaqet dhe kontekstin e lulëzimit, por në ligjshmëritë e brendshme të saj, në përcaktimin e vlerave dhe antivlerave, në deformimin e raportit të parimeve të poetikës të brendshme dhe faktorëve imponues jashtëletrarë” etj.^[6]

Gjatë viteve 1950-1975 shumë prej dramaturgëve bënë përpjekje që ta krijonin stilin e tyre të veçantë që do t’u përshtatej të gjithëve: rendit të ri shoqëror, pushtetarëve, popullit, masave punonjëse dhe, në fund, vetë krijuesit, i cili, në mes të gjithë këtyre, duhej të gjente mjete shprehëse dhe tema që nuk do të binin në konflikt me asnjërin nga elementët e cekur më lart. Prandaj, autorët duhet të kishin qasje qartësuese ideore dhe artistike në strukturën, përmbajtjen dhe kompozicionin e veprave dramaturgjike sipas koncepteve të realizmit socialist, sepse “kompozicioni përfshin në vetvete idetë që ka artisti rreth marrëdhënieve të njerëzve në shoqëri”^[7]. Kjo mënyrë shkrimi u shndërrua në metodë letrare dhe, sipas të njëjtave parime, analizoheshin, trajtoheshin nga interpretuesit nga (kritika letrare) veprat e tilla. Në këto kushte nuk bëhej më fjalë për ngritje të cilësive ideestetike,

por për manovrim mjeshtror në mes të gjithë këtyre faktorëve. Shprehja e lirë nuk ishte veçori e autorëve të realizmit socialist jo për paaftësinë e autorëve, por sepse sistemi nuk e pranonte atë krijim artistik që, në tekst apo nëntekst, nuk kishte elemente ideologjike. Me rëndësi për rendin e ri shoqëror nuk ishte krijimi kreativ artistik, por zbatimi i doktrinës së realizmit socialist.^[8] Po kështu, kjo metodë letrare, e cila u zhvillua në kampet socialiste, pamundësoi zhvillimin e letërsisë dhe, rrjedhimisht, të dramës e të teatrit sipas ligjësisë të natyrshme e sipas praktikave të tjera evropiane dhe botërore të krijimtarisë artistike, sepse “realizmi socialist është teori dhe praktikë letrare normative, që artin letrar ua nënshtron rregullave të caktuara ideore dhe estetike, kryesisht dogmatike, duke vënë atë në shërbim të ideve të revolucionit dhe të ideologjisë së partisë”^[9].

Pikërisht kjo arsye qëllimin për t'i identifikuar dhe studiuar vlerat artistike të pavëna re nga studimet dhe analizat e bëra deri tani mbi dramaturgjinë e viteve 1950-1975. Dramaturgjia shqipe e periudhës së realizmit socialist, apo siç parapëlqenin ta quanin këtë metodë letrare Brjusovi dhe Zamjatinë, si një realizëm i ri – “neorealizëm”, s'konsiderohet si krijimtari kuantitative dhe sidomos kualitative, ndaj çdo evidentim i çfarëdo kontributi i artistëve, që i shërben rritjes cilësore të trashëgimisë së letrave shqipe, vlen të evidentohet qoftë edhe për shkak të kësaj letërsie të damkosur me vulën e ideologjisë. Çështja tjetër që synon ta sjellë kjo monografi buron nga mendimi se duhet dhënë kah tjetër fenomenit të përjashtimit të dramave shqipe dhe historisë së letërsisë e cila merret me trajtimin e krijimeve artistike të periudhës së regjimit të realizmit socialist. Por, në këtë rast duhet identifikuar edhe faktin se ky lloj i letërsisë ka synuar që për aq sa është e mundur të ndodhë një simbiozë, një lloj bashkëjetese e pashkëputshme e artit me revolucionin (*Sinteza e artit dhe revolucionit*, Gj. Lukaçi). Ani pse metoda krijuese për strumbullar të vetin estetik kishte njeriun e revolucionit socialist, mbyllja e syve para këtyre krijimeve na krijon hendeqe në trajtimin e zhvillimit, së paku historik, të kësaj periudhe krijuese në kontekstin e gjithëmbarshtëm të zhvillimeve artistike dhe letrare. Çdo kulturë në botë ka lëvizjet dhe oscilimet e zhvillimit, po ashtu edhe letërsia shqipe prandaj, nëse mendohet se vetëm duke qenë “rënues” ndaj kësaj periudhe mund të afirmohet një letërsi dhe një shkencë e re, ky është amatorizëm shkençor, që e koncepton interpretimin e letërsisë thjesht dhe vetëm si qasje ideore (në çdo lloj kahu)^[10].

Krijimtaria dyzetvjeçare ekziston dhe ajo nuk shlyhet, e trajtimi dhe vlerësimi i saj i mbetet kohës.

Anashkalimi dhe mosinterpretimi i këtyre dramave do të linte një boshllëk në studimet dhe në kërkimet metodologjike në rrjedhën historike të dramës kombëtare. Historia nuk njihet periudha të zbrazëta, në kuptimin e zhvillimit të metodave, shkollave, rrymave, stileve apo, thjesht, në kuptimin e zhvillimit të saj vetjak, sado që ky zhvillim është i ndikueshëm nga faktorët e shumtë e të cilët, në rastin e metodës estetike socialiste, kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e letërsisë dhe gjinisë së dramës, por assesi nuk mund të pretendohet që kjo letërsi është inekzistente ngaqë, në të vërtetë, ajo është një lloj i vazhdimësisë së rrjedhave krijuese e të cilat paraqesin procese dialektike të zhvillimit të artit dhe kulturës.

Gjithsesi, “historia e ardhshme e letërsisë do të krijojë një rend tjetër të vlerave artistike-letrare nga ç'e ka krijuar kritika e sotme letrare. Duke i kundruar fenomenet letrare nga një distancë optimale historike, ajo do të mund të vërejë më objektivisht se cilët faktorë jashtëletrarë kanë ndikuar në afirmimin, popullarizimin dhe receptimin e veprës së një autori siç janë konjuktura e momentit, fryma e kohës, statusi shoqëror i autorit e të tjera”^[11]. Ky studim, edhe në rastin e emrave të përveçëm krijues të saj, ka provuar të mbështetet mbi këtë qasje të domosdoshme. Dramat e paraqitura në këtë monografi janë të shkruara brenda kornizave të kodikut të ri shoqëror, por duhet kuptuar se edhe brenda këtyre veprave ka forma të shkrimit dhe krijimit të cilat ia kanë dalë të sjellin elemente të reja dramaturgjike. Disa prej tyre janë marrë me probleme familjare, me emancipimin e gruas dhe zhvillimin e shoqërisë (tema të cilat iu janë përshtatur direktivave nën siglën e pasqyrimin të jetës me vërtetësi sipas zhvillimit revolucionar), megjithatë ndërtimi i tyre nuk ka qenë i vrazhdë dhe i zhveshur nga elementi estetik, të cilat nga aspekti kontekstual kanë arritur distancimin nga korniza e sistemit ideologjik, me theks të veçantë në zhanrin e satirës, komedisë dhe dramës historike. Bazuar në numrin e përgjithshëm të dramës së botuar, konstatojmë se një numër jo aq i madh dramash mund të konsiderohen si të “pastra ideologjike”.

Kudret Velça në njërin nga kritikantët e veta të kohës flet për dramën e aktualitetit^[12], të cilën e konsideron më të pëlqyerën e kohës. Sipas shpjegimit dhe arsytimit të tij, ai sqaron se ky term nënkupton dramën të cilat pasqyrojnë realitetin e metodës socialiste. E ky mendim, sipas studiueses A. Mullahi, është bastardizim i asaj drame që në zhvillimin e dramaturgjisë botërore quhet dramë propagandistike, e angazhuar dhe e lëvruar nga Brehti, ose drama me teze, drama

e ideve, e lëvruar nga Show.^[13] Teatri i Brehtit dhe drama e tij konsistonte në premisën se ky institucion mundëson një “riprodhim në tablo të gjalla të disa ngjarjeve reale ose të trilluara, në të cilat shtjellohen marrëdhëniet reciproke të njerëzve, një riprodhim që ka për qëllim zbavitjen... detyra më e përgjithshme e institucionit të quajtur teatër është dhënia e kënaqësisë”^[14]. Brehti besonte se duke i dhënë mundësinë publikut t'i shqyrtonte elementët e një situatë, teatri i shërbente qëllimit të çuarjes së këtij publiku drejt të kuptuarit më të mirë të shoqërisë në të cilën jeton.^[15] Ky është *parimi i karakterit edukativ i artit*, në këtë rast i letërsisë dhe dramaturgjisë realsocialiste duke pasur parasysh edhe konceptin e filozofisë materialiste. “Meqenëse Brehti shoqërinë njerëzore në kuptimin filozofik e ka trajtuar në linjën e një transformimi dialektik, në këtë linjë e ka trajtuar edhe teatrin dhe kahet e zhvillimit të tij. Sipas filozofisë dialektike, qenia shoqërore ndodhet në lëvizje dhe në kundërthënie permanente. Lëvizja dhe lufta e të kundërtave kërkon përsosmërinë e qenies njerëzore, kërkon përkryerjen e vetvetes. Prandaj, rrjedhimisht edhe teatri brehtian kërkon që duke u lëshuar në realitetin jetësor në mënyrë aktive të bëhet promovues i atyre lloj vlerave, që te spektatori ta nxisë procesin e të menduarit për ndryshueshmërinë e shoqërisë dhe transformimin e saj dialektik deri në përsosje”^[16].

Krijimtaria e dramës në Shqipëri për nga ana sasiore ishte prodhimtare dhe nga aspekti kompozicional si dhe struktura skenike ishte në nivel të lartë, por u cungua për shkak të përmbajtjes së imponuar të ideologjizuar të dramës dhe ndërtimit të personazhit dramatik e jo për shkak të autorëve dhe krijuesve. Kjo metodë krijuese për personazh kërkonte ta respektonte *heroin pozitiv* si një nga parimet qenësore të saj.

Përkundër dramës në Shqipëri, drama në Kosovë, e viteve 1950-1975, ishte mbrapa në aspektin sasior (kjo arsyeohet deri-diku

edhe me mungesën e teatrit në gjuhën shqipe dhe lëvrimin e vonët të saj), pavarësisht se përparësia e saj qëndronte në frymën më liberale të krijimtarisë se në Shqipëri. Kjo vërehet edhe në përmbajtjen e fabulës si dhe në ndërtimin e personazhit. Derisa Shqipëria e vazhdoi këtë trend të zhvillimit me hapa shumë të ngadalshëm, në aspektin ideor dhe tematik, drama në Kosovë nga fundi i viteve '60 dhe fillimi i viteve '70 arriti nivel të lartë krijues, duke u larguar përfundimisht nga dogma e realizmit socialist. Drama në Kosovë lëvrohej sipas metodave e poetikave avangardiste letrare, ishte moderne, me konceptione ekzistencialiste, madje mund të pohohet se ajo kishte tone të antidramës, pa çka se ishte e stërmëshur me figura stilistike, të cilat dramën e bënin disi hermetike e shumë simboliste. Ndërtimi i dramës shqipe në Kosovë të kësaj periudhe me autorët si: A. Pashku, A. Shkreli, R. Qosja, E. Kryeziu, B. Musliu etj. ishte më i avancuar, duke qëndruar larg tipareve të dramës së realizmit socialist, sipas parimit të *përmbajtjes socialiste dhe parimit të prishmërisë proletare*, prandaj ajo, si e tillë, nuk i përket qasjes së këtij studimi dhe për këtë arsye nuk është e përfshirë në këtë studim monografik. Në këtë studim monografik analiza çoi në përfundimin se kjo periudhë e realizmit socialist, në bazë të temave që frymëzuan krijuesit – dramaturgët – përbëhet nga pesë grupe të krijimtarisë. Klasifikimi i dramave është bërë mbi kriterin tematik (drama historike, drama e propagandës, drama familjare dhe e emancipimit shoqëror), grupi i dytë është klasifikuar sipas “kriterit përjashtues” – dramën jashtë kornizës së përcaktuar dhe sipas zhanrit – komedia dhe satira. Kjo metodologji ka synuar ta nxjerrë në pah dallimin në mes veprave dramaturgjike dhe se si autorët e ndryshëm iu qasën kësaj rrethane në mënyra të ndryshme për të krijuar drama që iu përmbaheshin rregullave në shikim të parë, por edhe si krijonin rrethana alternative për ta ngritur nivelin artistik, i cili nuk e për-

jashton faktin se nuk ka pasur edhe drama të tjera të cilat kanë trajtuar tema të tjera.

Këto drama brenda grupeve të tyre janë të renditura duke u bazuar në vitet e botimit të tyre.

[1] Edhe në i paçin shkruar *Numidët dhe Ines de Kastor* fillimisht në arbërishte, siç është hamendësuar prej pohimesh të thëna shkarazi nga vetë De Rada e Bazile ata, me shumë gjasë, do të kenë gjykuar se botimi i tyre në atë gjuhë do të ishte krejtësisht i padobishëm për synimet që i kishin vënë vetes. Prandaj historia e letërsisë shqipe s'ka ç'të bëjë tjetër veçse t'i marrë

dramat *Numidi* (Sofonisba), *Ines de Castro* dhe *Francesca da Rimini* si tregues të interesave të gjera krijuese të De Radës, Baziles e Darës që deshën, por pa shumë sukses, të qenë edhe pjesë e letërsisë italiane. Ata kërkuar lexuesin dhe spektatorin italian dhe vetëm se ishin arbëreshë, historia e letërsisë shqipe mund t'i shohë dramën e tyre me një mënyrë shumë të sipërfaqshme e jo fort bindëse si dukuri ndërkulturore. Shënime kritike nga Ali Xhiku, nga *Sprovë për një tjetër histori të letërsisë shqipe 1555-1944*, Albas, Tiranë, 2014, f. 152

[2] Hysen Matoshi, *Qasje albanologjike*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2016, f. 37

[3] Xhezair Abazi, *Jeta dhe procesi letrar*, Naim Frashëri, Tiranë, 1984, f. 232

[4] Jorgo Bullo, *Tradita dhe risi letrare*, Naim Frashëri, Tiranë, 1981, f. 5

[5] Erestina Gjergji-Halili, Orland Novaku, *Bibliografia e dramës së botuar shqipe (1883 - 2017)*, Parnas, Prishtinë, 2017

[6] Floresha Dado, *Letërsi e painterpretuar*, Bota Shqiptare, Tiranë, 2010, f. 11

[7] B. Breht, R. Foks, S. Finkelshajt, *Studime kritike*, Tiranë, f. 417

[8] Cary Nelson and Grossberg Lawrence, *Marxism and the interpretation of culture*, University of Illinois press, 1988, f. 5

[9] Agim Vinca, *Teori letrare: prej antikës deri te postmodernizmi*, Botim i dytë i përplotësuar, Libri Shkollor, Prishtinë, 2012, f. 302

[10] Floresha Dado, *Letërsi e painterpretuar*, Bota Shqiptare, Tiranë, 2010, f. 9

[11] Bajram Krasniqi, *Kode të ligjërit letrar*, Rilindja, Prishtinë, 1988, f. 200

[12] Grup autorësh, Kudret Velça, *Historia e teatrit shqiptar*, Vëllimi II, Instituti i Lartë i Arteve, Tiranë, 1984, f. 85

[13] Anila Mullahi, *Zhvillimi i dramës shqiptare gjatë periudhës së realizmit socialist*, Studime albanologjike, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë, 2010, f. 175

[14] B. Brecht, *Dialektika në teatër*, Rilindja, Prishtinë, 1973, f. 45-46

[15] B. Breht me trupën e tij artistike Berliner Ensemble, pati sukses dhe u përhap me shpejtësi jo vetëm në Gjermani, por në gjithë Evropën

[16] Emin Z. Emini, iipcl.org/wp-content/uploads/2015/07/Ajbals-all-2-fq-297-302.pdf



ANNO III.

Cosenza, 20 Gennaio 1886

NUM. 9.

FIÀMURI ARBËRIT

La Bandiera dell' Albania

PUBBLICAZIONE PERIODICA MENSILE

PER CURA D' UN COMITATO DI SIGNORI D' ALBANIA E DELLE SUE COLONIE

Lettere plichi ed altro inviarsi, franco di porto, all'incaricato della Direzione signor **Girolamo de Rada**, in MAKI, rione di S. DEMETRIO-CORONE.



ABBONAMENTO ANNUO

Per l'Italia L. 5, 00
Per l'Estero » 6, 50
Non si restituiscono i manoscritti.

Roli i shtypit arberesh në mbrojtje të çështjes kombëtare shqiptare

Nga: **Denisa TARE**

Në fillimin e shekullit XIX, mes shqiptarëve filluan të shfaqeshin, ashtu si kishte ndodhur me popujt e tjerë ballkanikë, rizgime kulturore dhe kombëtare që, në masë të madhe, i atribuoheshin veprimtarisë nxitëse kushtuar atdheut nga qendrat e emigrimit jashtë shtetit, më shumë se nga ato në brendësi të shtetit turk.^[1] Nxitjet në këtë drejtim vinin sidomos nga kolonitë shqiptare të Italisë jugore, që ndiqnin moton e Rilindjes italiane dhe që i kishte tërhequr perspektiva e përhapjes së kësaj lëvizjeje edhe në Shqipëri, duke çuar në rizgimin kombëtar të këtij vendi.

Në kuadër të një rilindjeje të tillë kombëtare u shfaqën nisimat e para në fushën e letrave në Itali nga ana e Vinçens Dorsës, Jeronim de Radës dhe Demetrio Kamardës. Ndërsa, në Shqipëri këto nisma u ndër-

morën nga disa intelektualë lokalë si Zef Jubani. Kështu, pikërisht i sipërpërmenduri Jubani, i cili në Shkodër kishte detyrën e sekretarit të Konsullit të Francës, porositi më 1871, në tipografinë e Triestes të kompanise austriake Lloid, shtypjen e një përmbledhjeje këngësh të Shqipërisë veriore, të përkthyer në italisht, duke u bashkëngjitur një tabelë fonetike të tyre në gjuhën e origjinës, si dhe disa konsiderata paraprake mbi “gjendjen morale dhe kulturën intelektuale të popullit shqiptar”.^[2] Nisma të ngjashme kishin lulëzuar në Egjipt nga Thimi Mitko, edhe në Rumani e Bullgari. Këto nisma ishin të drejtuara kryesisht nga përcaktimi i alfabetit dhe i rregullave gramatikore të gjuhës shqipe, si dhe në mbledhjen e rapsodive, këngëve popullore dhe studimeve mbi folklorin. Por, nuk mungonte edhe ideja e pavarësimit të Shqipërisë.^[3] Pararendës të lëvizjes që po

ndiqnin pavarësinë ose, të paktën, autonominë e Shqipërisë, ishin studiuesit e njohur shqiptaro-italianë si Jeronim de Rada, veprimtar sidomos që prej vitit 1848 me gazetën e tij “Shqiptari i Italisë” e më pas me botimin periodik “Flamuri Arbrit” i 1848-1887.^[4] Krahas tij, kishte edhe një brez të tërë arbëreshësh të angazhuar në çështjen shqiptare si Vinçens Dorsa, Dhimitër Kamarda dhe Zef Skiroi.

Shtypi i kohës mbetet një burim me vlerë për ndriçimin sa më të plotë të kësaj periudhe. Rrethanat në të cilat gjendej Shqipëria nën sundimin otoman, nuk lejuan që të lindte dhe të përhapej shtypi periodik brenda vendit. Vetëm jashtë Shqipërisë u arrit të krijoheshin periodikë të cilët ngritën zërin përpara Evropës, me qëllim njohjen e ekzistencës së kombit shqiptar dhe të së drejtës së tij për të qenë shtet i lirë dhe i pavarur. Gazetaria shqiptare luajti një rol të çmuar duke

ndihmuar çështjen kombëtare. Arbëreshë si Jeronim De Rada, Anselmo Lorekio, Terenc Toçi, Zef Skiroi, etj., kontribuuan duke e bërë të njohur çështjen kombëtare shqiptare në arenën ndërkombëtare. Këtë e realizuan duke u bërë nismëtarë në krijimin e organeve të para të shtypit shqiptar në Itali. Nga ana kronologjike, sipas të dhënave që kemi deri sot, njihet si organ i parë i shtypit shqiptar gazeta “L’Albanese d’Italia” (“Arbëreshi i Italisë”). Kjo gazetë doli në Napoli më 23 shkurt 1848. Në krye të saj qëndronte figura e Jeronim De Radës, rilindës i shquar i kohës. Jeronim de Rada botoi një nga organet e shtypit më me rëndësi të kohës të quajtur “Flamuri i Arbrit”, i cili filloi doli në Kalabri në vitet 1883-1887, në dialektin e arbëreshëve të Kalabrisë dhe italisht. De Rada, përmes “Flamurit të Arbrit” i bëri të njohur Evropës se ekzistonte një komb shqiptar, i cili ka

pasur një histori, një gjuhë, një traditë historike e, si rezultat, kishte mjaft të drejtë të aspironte për lirinë dhe pavarësinë e tij.

Krahas gazetave të lartpërmendura, me nismën e poetit arbëresh Xhuzepe Skiroi, u botua në 1887 në gjuhën arbëreshe dhe pjesërisht italisht Revista “Arbëri i ri”. Një gazetë tjetër me rëndësi ishte “La nazione Albanese” me drejtuesin e saj Anselmo Lorekio. Shtypi i kohës na tregon, edhe një herë, që ka dhënë ndihmesën e tij në fushën shoqërore, kulturore dhe politike gjatë periudhës së Rilindjes kombëtare shqiptare.

Shtypi arbëresh lindi si nevojë e domosdoshmëri për vetë ekzistencën kombëtare dhe shoqërore të dhjetëra-mijëra pasardhësve të brezëve që emigruan nga viset e ndryshme shqiptare, duke u ngulitur në trevat italiane në dhjetëvjeçarim e dytë të shekullit XV, sidomos

pas vdekjes së Skënderbeut.^[5] Shtypi arbëresh, që në zanafilë dhe sot, ka vijuar dhe vijon të zhvillohet duke lënë gjurmë në jetën e arbëreshëve, në lidhjet shqiptare dhe marrëdhëniet me Shqipërinë amë. Në gazetën e kohës, u trajtuan problematika të ndryshme të fushave letrare, kulturore, gjuhësore, folkloristike, shoqërore, pa lënë mënjanë çështjet politike. Shtypi arbëresh ka veçoritë e tij të krijimit dhe zhvillimit, që e bëjnë të ndryshëm nga zhvillimi i shtypit në vende të tjera ku kishin emigruar shqiptarët. Gazetaria arbëreshe shfaqet si nismë e dy apo tre personaliteteve, të cilët, për motive atdhetare, kulturore e shoqërore, botojnë një gazetë apo revistë (Jeronim De Rada, Zef Skiroi, Françesko Stesi Petka, Antonio Argondiza, Genaria Lusi, Françesko Cicero, Rosalina Petrota, etj.).^[6] Në të njëjtën kohë, ai lindi dhe u krijua me synime të qarta për të paraqitur jo vetëm problematikën kulturore, por dhe problemet sociale dhe politike që ndikonin në jetën e arbëreshëve jashtë vendit, por edhe atyre brenda vendit. Shtypi u shfrytëzua për qëllime të qarta nga ana e figurave të rëndësishme të kohës si Anselmo Lorekio, Terenc Toçi, Manilo Boniçi, etj., për të paraqitur orientimin e politikës zyrtare të shtetit ku kishin lindur dhe jetuar. U botuan organe të shtypit si nismë e përfaqësuesve të qarqeve politike italiane në gjuhën shqipe dhe italiane, me një platformë të qartë mbi Shqipërinë. Në këto organe të shtypit, numër pas numri, shfaqeshin problematika të ndryshme. Aty trajtoheshin hapur çështjet politike, të paraqitura si nismë e qarqeve politike të kohës. Në periudhën e Rilindjes kombëtare, depërtuan idetë iluministe, u hapën mundësi konkrete për zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe në krahinat e banuara nga popullsi shqiptare. Për të realizuar këtë zhvillim, ndihmuan rrethanat politike e kohës, por edhe grupet politiko-kulturore që vepronin jashtë administratës turke, në vende të ndryshme të botës. Të tilla ishin klubet dhe komitetet që, në atë periudhë, dhanë kontribut të madh në fushën arsimore, letrare dhe publicistike.^[7] Por krahas komiteteve apo shoqërive të kohës, rol të rëndësishëm luante dhe shtypi që, siç përmendet më lart, ndihmoi lëvizjen kulturore e cila zgjati afro 100 vjet. Në periudhën e Rilindjes Kombëtare, shtypi botohej jashtë administratës turke, edhe pse, gjatë asaj kohe, kemi pasur dhe gazeta apo revista që dolën brenda kufijve të Perandorisë Osmane. Shtypi, si

brenda dhe jashtë, në vende të ndryshme të Ballkanit, Evropës dhe gjetiu, luajti një rol në afrimin politik dhe kulturor të popullit shqiptar në përmasa botërore dhe u angazhua në përhapjen e arsimit në masat e popullit, në qytet apo fshat. Roli që luajtën shqiptaro-italianët (arbëreshët) në këtë proces të gjatë të zhvillimit arsimor, politik, social dhe kulturor, ka qenë i vazhdueshëm në periudha të ndryshme. Kryesisht, ky fakt u vu re gjatë Rilindjes Kombëtare. Karakteri demokratik i Rilindjes italiane u pasqyrua në faktin se, në lëvizje, mori pjesë jo vetëm popullsia e qyteteve, por edhe e fshatrave, veçanërisht në krahinat e Italisë Jugore. Format përmes së cilës vepruan rilindësit për çlirimin kombëtar ishin të ndryshme. Nga gjiri i fshatrave të jugut dolën emra të intelektualëve të rinj, të cilët njihen ende sot e kësaj dite dhe përbëjnë krenarinë e kolonive shqiptare. Ndihi për mëmëdheun e largët dhe dëshira për të çuar zërin e këtij atdheu përpara opinionit publik botëror, karakterizojnë veprimin e gjithë patriotëve shqiptarë të shekullit XIX. Këto synime të përmendura më sipër, ishin objektivi i luftës së atdhetarëve shqiptarë, si brenda dhe jashtë vendit. Një ndër mënyrat për të realizuar synimet e tyre ishte dhe veprimtaria edukative dhe propagandistike në masat e popullit. Figura të ndryshme patriotike si De Rada, Anselmo Lorekio, Terenc Toçi, etj., do ta nxisin këtë veprimtari përmes themelimit me plot sakrificë të periodikëve të parë shqiptarë si “*Flamuri i Arbrit*”, “*L’Albanese d’Italia*”, “*La Nazione Albanese*”. Gazetarë italo-shqiptarë përkrahën në shtypin botëror të drejtat e popullit shqiptar, njëkohësisht themeluan shoqëri shqiptare dhe komitete të cilat, më vonë, dhanë përkrahjen për ngritjen e kongreseve gjuhësore shqiptare.

[1] *Clayer, Arbëreshët e Italisë 1413-2007: antologji e autorëve francez...*, 332.

[2] *Zef Jubani, Raccolti di canti popolari e rapsodie di poemi albanesi, (Trieste 1871)*, 23

[3] *Historia e Shqipërisë...*, 130

[4] *Ahmet Kondo, Flamuri i Arbrit: çështja kombëtare, (Tiranë: Naim Frashëri, 1967)*, 82

[5] “*Shtypi arbëresh mes informimit dhe kulturës*”, *Albania, e shtunë 29 janar 2005*, 21

[6] *Po aty, f.21*

[7] *Sherafidin Hoxha, “Roli edukativ arsimor i shtypit periodik të periudhës së Rilindjes Kombëtare”, Shkëndija, Prishtinë, 1974, 20*

Shqiptarët dhe fuqitë e mëdha në vitet 1817-1818



Studiuesja Elena Kocaqi boton librin “Shqipëria dhe fuqitë e mëdha 1817-1918”. Në fokus është roli që kanë luajtur fuqitë e mëdha në copëtimin e trojeve shqiptare. Kocaqi rendit se si këto fuqi nuk morën parasysh asnjë parim kombësie, por vetëm fetar, kur ndan territoret shqiptare.

“Unë jam munduar që përmes dokumenteve diplomatike dhe

arkivore të sjell një histori të Shqipërisë me fuqitë e mëdha, të pacensuruar. Pa diskutim Perandoria Ruse ka qenë e para, ku mori kultus-protektoratin mbi ortodoksit e Ballkanit, që ka pas qëllim të zgjeronte në mënyrë artificiale elementin sllavë dhe elementin ortodoks në Ballkan. Edhe me anë të kësaj arriti të krijonte disa shtete, si është shteti grek si kundërpeshë

ndaj shtetit osman, që i mbronte me anë të fesë sesa me anë të etnisë. Pavarësisht se shqiptarët ishin ata që kontribuan në krijim e shtetit grek. Po e njëjta gjë u bë edhe në Serbi, që u krijua me insistimin rus në territoret e Shqipërisë së Veriut, po njësoj edhe në Mal të Zi, që doli në det edhe përfitoi një pjesë të territoreve të malësisë tonë”, thotë Kocaqi./ *Telegrafi*

Del nga arkivi filmi dokumentar për Nënë Terezën i realizuar 40 vite më parë



Sot në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup ishte për vizitë drejtori i institucionit kulturor “Vardar Film”, Naser Curri, i cili u prit nga drejtori i Institutit, Skender Asani.

Ky takim u realizua në kuadër të manifestimeve për shënimin e 40-vjetorit të shpalljes së Nënës Terezë për ‘Qytetare Nderi të Shkupit’. Me këtë rast drejtori Curri ia dhuroi ITSHKSH-së, përkatësisht Departamentit

Trashëgiminë e Gonxhe Bojaxhiut – Nënës Terezë një film dokumentar të realizuar para 40 vjetëve, që deri tash ka fjetur në arkivin e IN “Vardar Film”.

Duke e falënderuar për këtë dhuratë, drejtori Skender Asani tha: “Në këtë mënyrë Instituti po e mbledh trashëgiminë e Gonxhe Bojaxhiut dhe ngadalë po i tubon të gjitha elementet më të rëndësishme të jetës së Nënës Terezë në Shkup, për ta plotësuar mozaikun e fragmen-

tuar të jetës së kësaj nobeliste që është nder për kombin tonë, për qytetin tonë, për shtetin tonë, por edhe për gjithë botën”. Pas kësaj në sallën “W Wilson” të ITSHKSH-së nga të pranishmit u ndoq video-materiali i këtij dokumentari.

Gjithë kjo vjen si fryt i bashkëpunimit të mirë që ITSHKSH ka ngritur me IN “Vardar Film” dhe memorandumit për bashkëpunim që është nënshkruar qysh më herët ndërmjet dy institucioneve.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Gabojnë Prishtina dhe Ballkani, Drita forcon pozitën e parë

Prishtina dhe Ballkani kanë bërë nga një hap pas në garën për titull në Superligë, pasi në xhiron e 26 kanë marrë vetëm nga një pikë kundër Llapit, përkatësisht Ferizajt. Baras ka luajtur edhe Feronikeli me Drenicën



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 QERSHOR - FC Prishtina nuk ka mundur të marrë më shumë se një pikë nga ndeshja derbi ndaj Llapit pasi rezultati final ishte 1-1. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" ishte mjaft interesante dhe të dyja skuadrat "luftuan" shumë për fitore, por në fund që të dyja këto skuadra është dashur të pajtohen me nga një pikë. Kryeqytetasit shënuan të parët në pjesën e parë, kur pasimin fantastik të Meriton Korenicës e shndërroi në gol sulmuesi me përvojë të madhe Ahmed Januzi. Në fillim të pjesës së dytë, Mentor Zhdrella me një gol të bukur nga gjuajtja e lirë e barazoi rezultatin në 1-1. Edhe në minutat në vazhdim rastet nuk munguan, por gola të tjerë nuk pati. Pas kësaj ndeshjeje, Prishtina mbetet e dyta me 51 pikë, por tash ka katër pikë më pak se Drita që është lidere e elitës. Llapi mbetet në pozitën e

gjashtë me 38 pikë. Ashtu si Prishtina edhe Ballkani ka gabuar në këtë xhiro, pasi ka luajtur baras me Ferizajn (1-1). Në minutën e 17 Arbër Prekazi i kaloi mysafirët në epërsi, derisa dhjetë minuta para fundit të ndeshjes vendësit barazuan me eurogolën e Ermal Krasniqit. Ky barazim skuadrës së drejtuar nga Ismet Munishi, Ballkanit, i ka kushtuar me rënien në pozitën e katërt me 50 pikë. Ferizaj renditet në pozitën e dhjetë me 26 pikë. Ndeshje interesante u zhvillua edhe në Drenas, ku Feronikeli dhe Drenica luajtën baras 0-0. Skuadra vendëse ishte më e mirë dhe tentoi më shumë për t'i marrë tri pikët, por synimi i saj nuk u arrit dhe në fund është dashur të pajtohet me një pikë. "Nikli" me këtë barazim ia ka vështirësuar vetes punët në garë për pozitën e para, kurse Drenica po shkon sigurt drejt mbetjes në elitë. Skuadra kuqezi është në vendin e shtatë me 35 pikë.

IPKO Superliga

Feronikeli - Drenica	0-0
Llapi - Prishtina	1-1
Ferizaj - Ballkani	1-1
Trepça '89 - Flamurtari	1-1
Dukagjini - Gjilani	1-3
Vushtrria - Drita	0-4

Tabela

1. Drita	26	55 pikë
2. Prishtina	26	51
3. Gjilani	26	51
4. Ballkani	26	50
5. Feronikeli	26	44
6. Llapi	26	38
7. Drenica	26	35
8. Flamurtari	26	33
9. Trepça '89	26	28
10. Ferizaj	26	26
11. Vushtrria	26	16
12. Dukagjini	26	10

Në xhiron e radhës takohen: Drita-Dukagjini, Drenica-Trepça '89, Flamurtari-Ferizaj, Gjilani-Llapi, Ballkani-Vushtrria, Prishtina-Feronikeli.

SHKURT

Mitrovica - Feronikeli të shtunën ndajnë mejdantin për titull

Ndeshja përcaktuese për titullin e kampionit në Ligën e Femrave ndërmjet KFF Mitrovica dhe KFF Feronikeli do të zhvillohet të shtunën, më 27 qershor, me fillim nga ora 16:00 në stadiumin "Riza Lushta" në Mitrovicë. Ashtu sikurse në ndeshjet e IPKO Superligës, për shkak të pandemisë edhe kjo ndeshje do të zhvillohet pa tifozë dhe duke respektuar rekomandimet e institucioneve shëndetësore për mbrojtje nga Covid-19.

Vëllaznimi mbetet në Superligë

Vëllaznimi i Gjakovës edhe në edicionin e ardhshëm do të luajë në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave. Skuadra e hendbollit nga Gjakova fitoi ndaj KEK-ut me rezultat 33:26, në ndeshjen e plejautit për mbetje në Superligë. Radoniqi me 15 gola ishte më efikas te Vëllaznimi. Te KEK-u u dallua Kutillovci me 7 gola.

Rashicën e dëshiron edhe Hertha

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Milot Rashica, me shumë gjasë do të largohet nga skuadra e Werder Bremenit gjatë verës. Sipas mediave gjermane, garës për transferimin e Rashicës tani i është futur edhe Hertha BSC. Rashica pritet të largohet nga Werderi për shumë prej 15 milionë eurosh. Kohët e fundit, po ashtu, u raportua për interesimin e AC Milan për transferimin e futbollistit të Kosovës.

Shqipëria në tetor luan miqësore ndaj Armenisë

Kombëtarja shqiptare e futbollit do të luajë ndeshje miqësore ndaj Armenisë më 7 tetor 2020. Federata Shqiptare e Futbollit ka arritur tashmë një marrëveshje me Federatën Armene të Futbollit, që kjo ndeshje të luhet në kryeqytetin armen, Jerevan. Përveç miqësore, po në muajin tetor kombëtarja kuqezi do të zhvillojë edhe dy ndeshje zyrtare të vlefshme për UEFA Nations League ndaj Kazakistanit në udhëtim më 10 tetor dhe ndaj Lituaniës po në udhëtim më 13 tetor.

Dortmundi transferon Meunierin

Borussia Dortmund e ka zyrtarizuar transferimin e mbrojtësit Thomas Meunier nga PSG-ja. Mbrojtësi do ta bartë fanellën me numër 24, kurse skuadra gjermane e transferoi me parametrat zero, pasi belgut i skadoi kontrata me klubin francez. 28-vjeçari është pjesë e PSG-së nga viti 2016, derisa ka regjistruar 84 paraqitje dhe ka shënuar 8 gola.

Rossi: Fillimi i garës është momenti më i vështirë

ROMË, 25 QERSHOR - "Kur vjen momenti që nis gara, tensioni është i madh, përqendrimi është në maksimum, po ashtu edhe emocionet. Në ato momente shkarkohet shumë adrenalinë në sensin pozitiv. Mendoj se ai është

momenti më i keq, pasi nuk ndihesh mirë, nuk je i qetë". Ka qenë ky rrëfimi që ka bërë piloti italian Valentino Rossi, ikona e Moto GP që garon prej 20 vjetësh në kategorinë më të rëndësishme dhe numëron 9 tituj kampionë bote.

Italiani shprehet se nisja e garës është një nga momentet më të rëndësishme të vet garës. Gjithsesi, Rossi shprehet se ai jeton për t'i përjetuar këto emocione. "Kur nuk i përjetoj këto momente më duket sikur

nuk jetoj. Ekziston edhe frika se mos gabon apo bën ndonjë manovër të rrezikshme, por e gjithë kjo situatë është emocionuese. Në fund të fundit, garojmë pikërisht për këto momente", ka deklaruar Rossi.



FIBA publikon rregullat e reja

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Pas ndryshimeve të paraqitura nga komisioni teknik dhe miratuar nga Bordi Qendror i FIBA-s në mars 2020, FIBA ka publikuar Rregullat Zyrtare të Basketbollit 2020. "Këto ndryshime, të miratuara nga Bordi Qendror i FIBA-s, janë krijuar për ta ngritur standardin dhe cilësinë e lojës. Bashkëpunimi midis Komisionit të Lojtarëve të FIBA-s, Shoqatës Botërore të Trajnerëve të Basketbollit, Komisionit të Garave të FIBA-s dhe Grupit Këshillues të Rregullave, para se të ofrojnë propozime për Komisionin Teknik për shqyrtimin e tyre, kanë qenë shumë pozitive dhe konstruktive", ka thënë kryetari i Komisionit Teknik FIBA, Patrick Hunt. Sipas procedurës së vendosur, Grupi Këshillues i Rregullave të FIBA-s, i përbërë nga ekspertë të referimit, studiuin nga afër të gjitha propozimet për ndryshimet e



rregullave para se t'i paraqisnin ato pranë Komisionit Teknik të FIBA-s për rishikimin përfundimtar. Gjatë procesit, të gjithë aktorët kryesorë, përfshirë trajnerët, lojtarët, përfaqësuesit e NBA-së dhe NCAA-s, u përfshinë të gjithë në analizën e ndryshimeve të rregullave.

Ndryshimet kryesore të rregullave të reja përfshijnë:

Definicionin e "cilindrit" të lojtarit
Definicionin e faullit të dyfishtë
Definicionin e faullit josportiv në kundërsulm
Detyrat e zyrtarëve të ndeshjes
Përdorimin e sistemit instant të rishikimit dhe protokollet e raportimit
Specifikimet e pajisjeve të basketbollit

3x3 Prishtina marrin mbështetje nga FBK-ja

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu dhe sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, kanë pritur përfaqësuesit e klubit 3x3 Prishtina, Fikret Shatrin dhe Fisnik Junikon.

Temë e diskutimit të tyre kanë qenë aktivitetet e klubit 3x3 Prishtina gjatë muajit gusht dhe kërkesa për mbështetje nga FBK-ja për këtë aktivitet si dhe kërkesa nga 3x3 Prishtina për bashkorganizimin e aktiviteve në të ardhmen për lojën 3x3, me theks të veçantë në konkurrencën e femrave.

Në mesin e muajit prill, FIBA ka dërguar dy donacione për Federatën e Basketbollit të Kosovës (FBK). Bëhet fjalë për terrenin e lojës 3x3, semaforin 3x3, topat 3x3, topat e Mini-Basketbollit dhe topat për vajza. FIBA në fund të vitit pati vendosur ta shpërblejë FBK-në për punën e shkëlqyeshme që kjo e fundit e ka bërë gjatë vitit 2019 për zhvillimin e basketbollit ndër të rinj në Kosovë. Në fakt, ka qenë FIBA Evropa që e ka nominuar FBK-



në në mesin e dy Federatave Nacionale të Evropës për të qenë fituese e 350 topave Molten (të madhësisë 4, 5 dhe 3x3) për ta inkurajuar FBK-në që ta vazhdojë punën e shkëlqyer që po e bën, veçanërisht me të rinjtë. Loja 3x3 përkrahët nga FIBA dhe, për këtë arsye, Federata e Basketbollit e Kosovës do ta mbështetë çdo aktivitetet të masivizimit të kësaj loje. "Drejtuesit e FBK-së ishin pro kërkesave të përfaqësuesve

të 3x3 Prishtina dhe premtojnë se do të bëjnë çmos për të masivizuar këtë lojë në Kosovë. Kjo lojë është atraktive për të rinjtë dhe gjatë kësaj vere pritet të organizohen disa aktivitete, duke marrë parasysh se zhvillohen në ambiente të hapura dhe është më lehtë për shkak të pandemisë COVID-19, ku janë anuluar shumë aktivitete sportive në mbarë botën", thuhet në njoftimin e FBK-së.

SHKURT

Katër lojtarë dalin pozitivë me Covid-19 në NBA

Situatë aspak optimiste në NBA një muaj para rinisjes së kampionatit. Tre basketbollistë të Sacramento Kingsit dhe një i Indiana Pacersit kanë dalë pozitivë me Covid-19. Te skuadra e Sacramento kanë dalë pozitivë me koronavirus lojtarët Buddy Hield, Jabari Parker dhe Alex, ndërsa te skuadra e Indianas ka rezultuar pozitiv basketbollisti Malcolm Brogdon. Të katërt këta lojtarë janë në karantinë.

Të katërt këta lojtarë kanë dalë pozitivë pas testeve që kanë kryer të gjitha ekipet, para fillimit të fazës përgatitore. Duke parë se ka ende një muaj kohë deri në rifillimin e kampionatit (30 korrik), trajnerët shpresojnë t'i kenë lojtarët në Orlando, ku do të luhet pjesa e mbetur e sezonit.

Draxleri, besnik i PSG-së

Reprezentuesi i Gjermanisë, Julian Draxler, ka marrë vendimin për të ardhmen. Ai ka zgjedhur të qëndrojë te Paris Saint Germaini për ta respektuar kontratën që skadon në vitin 2021 dhe më pas të largohet me parametra zero. 26-vjeçari ka marrë përsipër rrezikun që të mos luajë titullar, por duke parë që klubi nuk do të bëjë një merkato agresive, lojtari mendon se do të ketë shanse edhe për të. Në drejtim të tij nuk mungojnë ofertat që nga Arsenali, Tottenhami, Atletico Madridi dhe Borussia Dortmundi, por duket se Draxler ka vendosur të qëndrojë.

Tetë të infektuar me Covid-19 në klubin elitare rus

Koronavirusi ka prekur në masë klubet e futbollit në Rusi. Të enjten janë konfirmuar tetë persona të tjerë të infektuar me Covid-19. FC Orenburg ka dalë me deklaratë dhe bën me dije se 6 futbolistë dhe 2 pjesëtarë të stafit janë testuar dhe kanë dalë pozitivë. Kjo situatë ndodh dy ditë para ndeshjes që FC Orenburg ka me skuadrën Krasnodar. Para pak ditëve kësaj skuadre iu shty një tjetër ndeshje, ajo kundër Dynamo Moscowit. Shkak ishin disa lojtarë të skuadrës ruse që ishin prekur nga koronavirusi. Ata ishin testuar para ndeshjes me Lokomotiv Moscowin që u zhvillua më 21 qershor. Testet e fundit i kanë nxjerrë pozitivë dhe lojtarët dhe pjesëtarët e stafit janë të detyruar të qëndrojnë të izoluar.

Ndombele nuk luan për Tottenhamin derisa Mourinho të jetë trajner

Tanguy Ndombele është blerja më e shtrenjtë në historinë e Tottenhamit teksa skuadra londineze pagoi 62 milionë euro, plus 10 të tjera bonus. Megjithatë, aventura e francezit në kampionatin anglez nuk po shkon aspak mirë sepse fillimisht vuajti përshatjen me Maurizio Pochettinon, ndërsa tani nuk po arrin ta bindë Jose Mournhon që t'i japë një vend titullari. Tekniku portugez dhe mesfushori mësohet se kanë debatuar ashpër të hënën, fillimisht në fushën e stërvitjes dhe më pas në zyrën e Mourinhos, pasi ky i fundit i kishte theksuar se nuk është ende gati për të luajtur. Ndombele ka reaguar ashpër dhe i ka thënë Mourinhos se nuk do të luajë më sa kohë që ai është trajner i Tottenhamit.

Pensionohet Mathieu

Një lëndim i rëndë ka përshpejtuar pensionimin nga futbolli për mbrojtësin Jeremy Mathieu. Francezi së fundi ishte pjesë e Sporting Lisbonës në Portugali, ndërsa gjatë karrierës së tij ka veshur edhe fanellën e Valencias dhe Barcelonës. Në fakt, nëse Barcelona ka ditur të habitë me transferimin e mbrojtësve të qendrës, Mathieu pikërisht ka qenë një prej tyre. Barcelona në vitin 2014 pagoi 20 milionë për francezin, që atëkohë kishte 30 vjet, duke u bërë mbrojtësi më i shtrenjtë në histori për moshën e tij. Për katalanët, Mathieu ka regjistruar 62 paraqitje, duke shënuar tri gola.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "A- Technology", SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me NRB:810192534, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "A- Technology" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 810192534, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "A- Technology" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810192534 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Ramë Bllaca" – Bllacë
 Komuna: Suharekë
 Data: 23.06.2020
 Emri i kontratës: Tabelë shkrimi lëvizëse
 Numri i kontratës: ESIP/SDG/053–G/1.2

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Shkollën "Ramë Bllaca" në Bllacë – Suharekë. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:

- Një- Tabelë shkrimi lëvizëse

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit.
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën Shfmu Shkollës "Ramë Bllaca" në Bllacë – Suharekë, më së largu deri më 01.07.2020

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur "Ftesë për ofertë-Mallra", do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Shkelzen Zekolli
 Telefoni: 044/823-348
 E-maili: shkelzenzekolli@hotmail.com



RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Samir Micaj shpall të pavlefshme dëftesat certifikatën diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Fatmire Bajraktari shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Lekë Dugagjini " Prizren.

► Azem Kukaqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf " Haziz Tolaj " Arbane

► Azem Hoti shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " 4 Dëshmorët " Ratkocb.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardani. Banesa është 50 m2, e mobiluar në tersi dhe është e gatshme për banim. Banesa preferohet për qift familjar. Tel: 044-171-328.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoh një banesë me qira në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Breguri i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR ARSIM

Nr-4: 670-25540
Datë: 25.06.2020

Në mbështetje të nenit 7 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15 Nr. 670-19941 të datës 29.05.2020 dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës 1Nr.670-24576 të datës 22.06.2020 për caktimin e numrit të bursave dhe shumës financiare për një bursë për studentë për vitin akademik-shkollor 2020/2021, Drejtorati për Arsim i Komunës së Lipjanit shpallë:

**KONKURS
PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË LIPJANIT**

Komuna e Lipjanit ndanë 80 (tetëdhjetë) bursa për studentë të cilët studiojnë në Universitetet publike të Republikës së Kosovës për vitin akademik 2020/2021. Vlera e bursës është 500 € për vitin akademik.

Kushtet dhe kriteret:

- Të drejtë për të aplikuar për bursë komunale kanë studentë të cilët i plotësojnë këto kushte:
 - Të jenë banorë rezident të Komunës së Lipjanit,
 - Të jenë të regjistruar në vitin akademik për të cilin ndahen bursat,
 - Të kenë certifikatën e notave,
 - Të mos jenë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër për vitin e njëjtë akademik,
 - Të mos jenë të punësuar.
- Niveli i studimeve për të cilën ndahet bursa është themelore (bachelor), studentë aplikues duhet të jenë të regjistruar së paku në vitin e dytë të studimeve.
- Studentët do të vlerësohen me pikë nga Komisioni duke u bazuar në sukseset e arritura në vitin paraprak në pajtim me kriteret e përcaktuar me dispozitë të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15 Nr. 670-19941 të datës 29.05.2020

I. Bursa për studentë të Universiteteve Publike të vendit për fakultetet:

- Fakulteti i SHMN - Matematike
- Fakulteti i Ndërtimtarisë
- Fakulteti i Arkitekturës
- Fakulteti i Gjuhë Gjermane
- Fakulteti i Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike
- Fakulteti i Mjekësisë
- Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara
- Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore
- Fakulteti Filozofik
- Fakulteti i Edukimit: Programi fillor
- Fakulteti SHMN
- Fakulteti Filologjik
- Fakulteti Juridik
- Fakulteti Ekonomik

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Ekstraktin e lindjes
- Kopja e letërnjoftimit
- Certifikata mbi vendbanimin
- Deklaratën e bashkësisë familjare
- Certifikatën e notave
- ID e fakultetit
- Konfirmimin e llogarisë bankare
- Vërtetim nga fakulteti që nuk merrni bursë nga fakulteti
- Dokumentin zyrtar të lëshuar nga organi kompetent si dëshmi se është është fëmijë i dëshmorit, invalidit, veteranit dhe martirit të luftës së UÇK, është person me aftësi të kufizuara, në asistencë sociale si dhe dëshminë se nuk i ka prindërit në jetë.

- Aplikacioni merret në zyrën e pranimit të Komunës dhe dorëzohet në këtë zyrë në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit.

Shënim:
-Të gjitha dokumentacionet e kërkuara duhet të jenë origjinale
-Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen

Shënim:
Rregulloren për Ndarjen e Bursave për Student mund ta gjeni në faqen e Komunës

Drejtoresha e DKA-së
Elmaza Behluli







Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerziteteske Bolničke i Kliniçke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmureve Kronik Psikiatrik - Shtime



Duke u bazuar në njoftimin nga Zyra e Burimeve Njerëzore të SHSKUK-së të bazuar në rekomandimin e Ministrisë së Shëndetësisë, drejtori i QIRSKP-Shtime, merr këtë :

V E N D I M

- ANULOHET** konkursi publik i datës 12.06.2020 për pozitën e punës Ndhmës mjekësor
- Vendimi të publikohet me datë 26.06.2020 në njërin nga të përditshmet ditore (gazet) të shtypit, komfor UA 07/2017
- Obligohet zyra e personelit në QIRSKP-Shtime që të zbatoj këtë vendim.

Me respekt,
Dr. Mihtar Zenelaj
Drejtor në QIRSKP-Shtime

Datë 25.06.2020



LAJMËROJMË

Bashkëpronarët : Mustafa Fikret (Daut) nga Prizreni rr.Gjevdet Doda nr 59 me pjesën ideale prej 2/3 ,Ymerli Pulaj (Musli) nga Prizreni rr.Tahir Sinani ,me pjesën ideale prej 58/330 ,Morina Luan (Skender)nga Prizreni rr.B Curri ,me pjesën ideale prej 14/330 dhe Driton Morina (Skender) nga Prizreni rr.Bajram Curri me pjesën ideale prej 18/330,nga Prizreni si blerës potencial se,

Unë Bashkëpronari Orlovic Novica (Budimir) me letërnjoftimin nr 1502089630 jeton në Verbishtic KK Shtërpce si bashkëpronar ligjor I parcelës kadastrale nr P-71813068-09011-0 që ka sipërfaqe të përgjithshme prej 7123 m2,në zonën kadastrale Prizren,po shes pjesën time bashkëpronësore me pjesë ideale prej 20/330 në sipërfaqe prej 432 m2.

Në këtë mënyrë I ofroj bashkëpronarve,që në rast se janë të interesuar për blerje,të lajmërohen brenda afatit prej 30 ditësh ,në adresën e fshatit Vrbishtic KK Shtërpce.

Njëheri informoj se kam blerësin potencial I cili Brenda afatit të lartpërmendur prej 30 ditëve do të paguj shumën prej 85.000.00 euro (tetëdhjetepesëmijë euro) me para të gatshme bazuar në ligjet në fuqi.

Numri I kontaktus +383(0)49166271



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

